

**Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve dhe
Ndërtimi i Marrëdhënieve
Sfidat e Normalizimit mes Kosovës dhe Serbisë**

Përmbajtja

Parathënie dhe falenderime

Përkrahja e dialogut të Brukselit

Krijimi i Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbe

Integrimi i veriut të Kosovës dhe pjesëmarrja politike e serbëve

Bashkëpunimi parlamentar

Bashkëpunimi në integrimet evropiane

Pjesëmarrësit

Originali në gjuhën angleze dhe përkthimi në gjuhën serbe i këtij raporti mund të gjenden në www.cigonline.net

**Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve dhe
Ndërtimi i Marrëdhënieve
Sfidat e Normalizimit mes Kosovës dhe Serbisë**

**Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Nju Jork, 2015**

PARATHËNIE DHE FALENDERIME

Marrëdhëniet mes Kosovës e Serbisë janë të vështira.

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008, të gjitha kontaktet mes zyrtarëve të Kosovës dhe Serbisë u ndërpreu. Beogradi refuzonte çfarëdo bashkëpunimi me Prishtinën, duke preferuar që ta kanalizonte atë përmes Misionit të BE-së për Sundim të Ligjit, dhe Misionit të KB-së në Kosovë. Megjithatë, të inkurajuar nga BE-ja dhe SHBA-të, zyrtarët e lartë të të dyja qeverive u takuan në mars të vitit 2011, në negociatat e drejtpërdrejta në Bruksel. Këto neogociata u pasuan me takimin mes kryeministrave të Kosovës e Serbisë në tetor të vitit 2012. Dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja rezultoi në arritjen e një numri marrëveshjesh mes Serbisë e Kosovës, përfshirë Marrëveshjen e Brukselit të muajit prill, 2013. Qëllimi kryesor i Marrëveshjes është përmbyllja e integritet të komunave me shumicë serbe në veriun e Kosovës në sistemin ligjor dhe qeverisës të Kosovës, duke përfshirë edhe krijimin e Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Palët, poashtu, janë zotuar mos ta bllokojnë njëri tjetrin në procesin e anëtarësimit në BE.

Implementimi i Marrëveshjes së Brukselit ka qenë i vështirë dhe i dhimbshëm. Përderisa një numër çështjesh janë zgjidhur dhe janë zbatuar, përfshirë lirinë e lëvizjes, integritetin e policisë, menaxhimin e kufijve dhe mbajtjen e zgjedhjeve në veri, deri në këtë moment, më shumë se dy vite e gjysëm pas fillimit të negociatave, Marrëveshja nuk është zbatuar ende. Asociacioni/Komuniteti ende nuk është krijuar, dhe strukturat paralele administrative të Serbisë janë ende funksionale në Kosovë. Serbia fajëson Kosovën, dhe Kosova Serbinë për këtë mungesë zbatimi dhe, si njëra, ashtu edhe tjetra, kërkojnë angazhim më aktiv të BE-së si garantuese e marrëveshjeve. Në Beograd nuk ka ndonjë kundërshtim thelbësor ndaj Marrëveshjes. Megjithatë, lufta e zjarrtë kundër anëtarësimit të Kosovës në UNESCO, dhe posaçërisht gjuha e përdorur nga një numër i zyrtarëve serbë, e ka dëmtuar mjaft shpirtin e normalizimit të marrëdhënieve. Në Prishtinë, qysh nga vjeshta e vitit 2015, mospajtimi i opozitës me dispozitat e Brukselit, posaçërisht në lidhje me Asociacionin/Komunitetin, është përshkallëzuar në protesta të dhunshme në rrugë, dhe në pengimin e vazhdueshëm të punës së parlamentit.

Mungesa e implementimit dhe tensionet e ngritura kanë penguar procesin e normalizimit të dyanshëm të marrëdhënieve të filluar në Bruksel, si dhe normalizimin e marrëdhënieve mes komunitetit shqiptar dhe atij serb në Kosovë.

Marrëdhëniet e mira mes Kosovës e Serbisë, dhe mes serbëve e shqiptarëve në përgjithësi, janë thelbi i stabilitetit në Ballkan. Është qenësore që normalizimi të mos dalë nga binarët, edhe nëse disa nga dispozitat e marrëveshjes rishikohen dhe ndryshohen. Rajoni nuk do të ecë para pa përmirësimin e këtyre marrëdhënieve strategjike.

Me qëllim të adresimit të këtyre çështjeve kyçe, Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG), në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës (FDFA), gjatë vitit 2014 dhe 2015, ka zhvilluar një program mbi Normalizimin e Marrëdhënieve Kosovë-Serbi, dhe Integritetin e Veriut të Kosovës. Pjesëmarrësit në këto aktivitete kanë qenë

zyrtarë të qeverive dhe parlamenteve të Kosovës e Serbisë, zyrtarë të partive politike, si dhe përfaqësues të shoqërive civile dhe botës akademike. Në këto programe kanë marrë pjesë poashtu diplomatë të lartë zviceranë dhe të BE-së. Përveç dialogut të sponsorizuar nga BE-ja, procesi i CIG-FDFA është e vetmja platformë e vazhdueshme për zyrtarët e Beogradit dhe Prishtinës. Për më shumë, procesi “*track 1.5*” i CIG-FDFA përfshinë negociatorët kryesorë të qeverisë së Kosovës dhe Serbisë, si dhe zyrtarë tjerë kyç.

Përmes tryezave të shumta, punëtorive, paneleve, diskutimeve në grupe të vogla dhe individuale, dhe aktiviteteve tjera, CIG ka mundësuar që pjesëmarrësit së bashku t’i eksplorojnë zgjidhjet e mundshme të problemeve specifike në implementimin e marrëveshjes së Brukselit, të ofrojnë rekomandime se si të rregullohet dhe shtyhet procesi para, si dhe të shqyrtojnë idetë në lidhje me krijimin e Asociacionit/Komunitetit. Pjesëmarrësit e kanë shtyer para procesin e normalizimit. Procesi i CIG-FDFA ka ofruar kontribut qenësor në krijimin e një mirëputimi të shtuar mes palëve, si në përmirësimin e njohurive të tyre për pozicionet e njëri tjetrit, ashtu edhe në kuptimin e të metave dhe limitimeve të kërkesave të tyre maksimale. Si pasojë e këtyre aktiviteteve, shumë nga pjesëmarrësit kanë moderuar pikëpamjet e tyre.

Procesi i CIG-FDFA ka shkuar përtej kornizës zyrtare të Brukselit, dhe ka hapur kanale të reja të bashkëpunimit mes Kosovës e Serbisë, me theks të veçantë në mes të deputetëve të parlamentit të Kosovë dhe Serbisë, përmes krijimit të Grupit të Bashkëpunimit. Grupi përbëhet nga rreth 12 deputetë nga të dyja parlamentet. Procesi i CIG-FDFA poashtu ka inicuar bashkëpunimin praktik mes zyrtarëve të Ministrisë së Integritimit Evropian të Kosovës dhe Zyrës për Integritimit Evropian të Qeverisë së Serbisë.

CIG është e përkushtuar të vazhdojë të kontribuojë në këto fusha.

Faqet në vazhdim ofrojnë përmbledhje të diskutimeve më të rëndësishme të organizuara si pjesë e procesit të CIG-FDFA, dhe i prezantojnë lexuesit një pamje dinamike të evoluimit të pikëpamjeve të pjesëmarrësve, marrëveshjeve e mosmarrëveshjeve, si dhe ideve e propozimeve të tyre. CIG mbanë përgjegjësinë e plotë për këtë publikim, i cili nuk është rishikuar paraprakisht nga pjesëmarrësit.

Në këtë publikim janë theksuar pesë temat kryesore të punës së CIG në këto dy vitet e fundit: (1) aktivitetet në përkrahje të dialogut të sponsorizuar nga BE-ja dhe zbatimi i marrëveshjeve që dalin nga ai; (2) aktivitetet që kanë të bëjnë me krijimin e Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbe në Kosovë; (3) integrimi i veriut të Kosovës dhe përmirësimi i përgjithshëm i pjesëmarrjes së serbëve në jetën politike të Kosovës; (4) vendosja e bashkëpunimit mes deputetëve të parlamenteve të Kosovës e Serbisë; dhe (5) fillimi i bashkëpunimit mes Beogradit e Prishtinës në fushën e integritimit evropian.

Ne në CIG jemi krenarë për bashkëpunimin me Zvicrën dhe departamentin e saj për punë të jashtme, dhe u jemi sinjerisht falenderues kolegëve dhe miqve tanë, ambasadorëve Krystyna Marty Lang dhe Jean-Daniel Ruch, e poashtu Talia Wohl, Saskia Salzmann e Norbert Rütche. Poashtu, u jemi falenderues ambasadorëve Heidi Grau dhe Clauë Wild, si dhe Roland Salvisberg, për mbështjetjen e tyre të pazërvë të aktiviteteve të CIG, besimit të tyre në punën dhe misionin

tonë, dhe bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm. Kjo iniciativë dhe rezultatet e saj nuk do të ishin të mundura pa kontributin e tyre thelbësor.

Poashtu, u jemi falenderues shumë prej kolegëve tanë në Bashkimin Evropian, për pjesëmarrjen dhe përkrahjen e tyre. Posaçërisht u jemi falenderues Përfaqësuesit Sepcial të BE-së në Kosovë, Samuel Žbogar, dhe ushtruesit të detyrës së Drejtorit për Ballkanin Perëndimor të Drejtoratit Gjeneral për Zgjerim dhe Politike të Fqinjësisë të Komisionit Evropian, Catherine Wendt, si dhe Pierre Mirel, Drejtor Gjeneral Nderi i Komisionit, për kontributin e tyre të vazhdueshëm në këtë proces.

Shfrytëzojmë mundësinë që të falenderojmë anëtarët e bordit të drejtorëve të CIG, Dr. Steven Burg, Dr. Gordon Bardos dhe Michael Elf, për përfshirjen e tyre aktive në punën e CIG, dhe këshillat e tyre shumë të vlefshme.

Ky program nuk do të ishte i mundshëm pa punën e zëvendës-presidentit të CIG, Shpëtim Gashi, i cili ka përgatitur këtë raport. Poashtu, u jemi falenderues për kontributin e tyre kolegëve tanë në Beograd dhe Prishtinë, Igor Novaković dhe Arbër Kuçi.

Alex Roinishvili Grigorev, President
dhjetor, 2015

PËRKRAHJA E DIALOGUT TË BRUKSELIT

Përfshirja e temave të reja

Në prill të vitit 2014, CIG ka organizuar në Beograd një punëtori për një numër analistësh nga Kosova dhe Serbia, në lidhje me marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë. Pjesëmarrësit kanë hartuar një listë të çështjeve shtesë për t'u marrë parasysh nga Beogradi dhe Prishtina, me qëllim të shtyerjes para të procesit të normalizimit.

- *Anëtarësimi në organizata ndërqeveritare:* Marrëveshja e prillit të vitit 2013 i lejon Kosovës anëtarësimin në organizata rajonale, por jo edhe në ato ndërkombëtare. Një gjë e tillë pengon bashkëpunimin e qëndrueshëm dhe normalizimin e marrëdhënieve. Pjesëmarrësit kanë propozuar që kjo çështje të jetë si pikë e veçantë në agjendën e dialogut.
- *Njohja e dyanshme e sistemeve ligjore:* Beogradi dhe Prishtina duhet t'i njohin vendimet ligjore të gjykatave të njëri tjetrit. Tani për tani, vendimet gjyqësore në Kosovë, si p.sh. ato për divorce, nuk njihen në Serbi. Një njohje e tillë e dyanshme do ta përmirësonte në mënyrë të drejtpërdrejt jetën e njerëzve në Kosovë e Serbi.
- *Vendosja e bashkëpunimit të drejtpërdrejt mbi çështjet e sigurisë:* Prishtina dhe Beogradi duhet të vendosin dhe fuqizojnë bashkëpunimin mes forcave të tyre të policisë, inteligjencës, dhe gjykatave, me qëllim të luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Pjesëmarrësit poashtu kanë propozuar zgjidhjen e çështjes së strukturave paralele të mbetura në veri të Kosovës, siç janë Njësitet e Mbrojtjes Civile
- *Asociacioni/Komuniteti i komunave me shumicë serbe:* Asociacioni/Komuniteti duhet të formohet menjëherë pas zgjedhjeve parlamentare në Kosovë. Ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të merret me problemet konkrete të komunitetit serb, e jo të shëndrrohet në institucion politik. Shumë prej pjesëmarrësve kanë theksuar se Asociacioni/Komuniteti nuk ka mundur të formohet pa funksionimin e plotë ligjor të institucioneve lokale në veri. Disa prej tyre kanë propozuar që selia e Asociacionit/Komunitetit të jetë në Gracanice, e disa tjerë në kanë propozuar që selia të jetë në Mitrovicë.
- *Personat e zhdukur:* Pesëmbëdhjetë vite pas luftës, rreth 1,800 persona janë ende të zhdukur. Prej tyre, rreth 1,400 janë shqiptarë, kurse rreth 400 serbë të Kosovës. Edhe pse të dyja qeveritë kanë bashkëpunuar në këtë çështje, dhe shumë nga të zhdukurit janë gjetur, pjesëmarrësit kanë thënë se procesi duhet të intensifikohet dhe kjo çështje duhet zgjidhur njëherë e përgjithmonë. Është e vështirë të shënohet përparim thelbësor në normalizimin e marrëdhënieve, kur ende vazhdojnë të zbulohen varreza masive.
- *Liria e lëvizjes:* Liria e lëvizjes, ashtu siç është definuar në Marrëveshje, duhet rishikuar. Edhe pse njerëzve u lejohet të udhëtojnë në shtetet e njëri tjetrit, kufiri dhe pagesat e sigurimit për një kohë kanë qenë astronomike. Një vozitës nga Kosova është dashur të paguajë rreth 130 euro për të hyrë në Serbi. Edhe pse qeveria e Kosovës e ka zvogëluar dukshëm këtë shumë për vozitësit serbë, megjithatë pagesa ka qenë një barrë domethënëse. Çështja e pagesës së sigurimeve është zgjidhur, por targa e automjeteve të Kosovës ende nuk njihen nga Serbia.
- *Rregullimi i sistemit arsimor dhe shëndetësor në Kosovë:* Serbët e Kosovës kanë filluar t'i shpërbëjnë institucionet politike paralele duke marrë pjesë në zgjedhjet e Kosovës, por ende i

mbajnë funksionale shërbimet institucionale paralele në arsim dhe shëndetësi. Pjesëmarrësit kanë rekomanduar që këto institucione nuk duhet të mbyllen, por të rregullohen.

- *Pretendimet territoriale:* Pretendimet territoriale të Serbisë ndaj Kosovës paraqesin një pengesë permanente në procesin e normalizimit të marrëdhënieve. Shumë folës shqiptarë kanë thënë se është e vështirë të normalizohen marrëdhëniet me dikë i cili ka pretendime ndaj territorit tënd, dhe se në Kosovë, Beogradi do të vazhdojë të shihet si kërcënim për sigurinë, përderisa ekzistojnë pretendime të tilla.

Në fund, pjesëmarrësit kanë theksuar se ka mjaft frustrim në lidhje me implementimin e Marrëveshjes së Brukselit, dhe kanë propozuar që BE-ja të jetë garantues i qartë në këtë proces, në mënyrë që implementimi të bëhet sipas afateve kohore të parapara.

Implementimi i Marrëveshjes së Brukselit

Në shkurt të vitit 2015, CIG ka organizuar në Bruksel një diskutim të politikave rreth implementimit të Marrëveshjes së Brukselit dhe perspektivës së integritimit evropian për Serbinë dhe Kosovën. Pjesëmarrës në këtë tryezë kanë qenë ministra dhe anëtarë të lartë të qeverisë së Kosovës e Serbisë, anëtarë të parlamenteve, përfaqësues të shoqërisë civile nga Serbia e Kosova, zyrtarë të Komisionit Evropian, dhe anëtarë të Parlamentit Evropian. Diskutimi është fokusuar në Asociacionin/Komunitetin, dhe perspektivën e integritimeve evropiane për Serbinë dhe Kosovën.

Serbët dhe shqiptarët kanë pasur dallime të papajtueshme rreth Asociacionit/Komunitetit. Folësit nga Kosova kanë thënë se Asociacioni/Komuniteti duhet të jetë mekanizëm koordinues, dhe të bazohet në ligjet e Kosovës. Folësit serbë kanë thënë se Asociacioni do të bazohet në “ligjet e Kosovës, por jo në ligjet ekzistuese të Kosovës”, duke thënë që ata presin nga Prishtina t’i ndryshojë një numër ligjesh që do t’i jepnin Asociacionit/Komunitetit fuqi ekzekutive. Përfaqësuesit e Kosovës kanë shpjeguar se si Prishtina, ashtu edhe Beogradi janë pajtuar t’i ndryshojnë disa ligje, por vetëm me qëllim të akomodimit të Marrëveshjes së Brukselit në formën e saj ekzistuese.

Përfaqësuesit serbë kanë thënë se Asociacioni/Komuniteti duhet të marrë disa nga përgjegjësitë e institucioneve paralele, përfshirë kompetencat për të marrë vendime rreth planifikimit hapësinor, marrjes së huave financiare, dhënien e tenderëve dhe krijimin e agjencive publike. Në sistemin paralel në Kosovë janë mbi 5,000 të punësuar, dhe Beogradi dëshiron që disa nga këta të punësuar të transferohen tek Asociacioni/Komuniteti. Një folës ka thënë se një gjë e tillë është në pajtim me standardet e BE-së. Ai ka pranuar se një institucion me aq kompetenca do të mund të ishte “*sui generis*”, por ka thënë se një gjë e tillë nuk do të ishte problem. Një folës nga Kosova u ka propozuar kolegëve të tij nga Beogradi të mos i ngrisin pritjet e serbëve në Kosovë përmes kërkesave të tilla “të pamundshme”. “Një institucion i tillë është i barabartë me një status autonom, dhe si i tillë nuk ka gjasa të realizohet”.

Në lidhje me procesin integruar të BE-së, përfaqësuesit e Kosovës dhe Serbisë janë pajtuar se të dyja qeveritë duhet të bashkëpunojnë. Ka pasur pajtim të gjërë se të dyja qeveritë janë të ndërvarura, dhe se kanë nevojë për njëra tjetrën për të arritur progres thelbësor. Një folës ndërkombëtar ka thënë se implementimi i plotë i Marrëveshjes do të ishte i mjaftueshëm për

fillimin e negociatave me Beogradin për anëtarësim në BE, por se do të duhet të ketë “më shumë marrëveshje të llojit të marrëveshjes së Brukselit me Kosovën para anëtarësimit të plotë”.

Përfaqësuesit serbë kanë thënë se negociatat duhet të hapen sa më shpejtë që është e mundur “pasiqë Serbia i ka përmbushur kushtet duke bërë një numër marrëveshjesh me Kosovën”. Por përfaqësuesit e Kosovës dhe një numër i folësve ndërkombëtarë kanë thënë se “marrëveshjet pa implementim nuk janë të dobishme”. Një folës nga Kosova ka thënë se Prishtina është dashur ta rinegociojë marrëveshjen mbi gjykatat në veri, edhe pse paraprkisht ishin pajtuar që ajo të implementohet deri në fund të vitit 2013, dhe është ankuar se tani Serbia është duke e portretizuar atë si marrëveshje të re.

Një numër i folësve ndërkombëtarë dhe përfaqësuesve të Kosovës u kanë bërë thirrje pesë shteteve të BE-së që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës ta bëjnë një gjë të tillë. Ata kanë thënë se këto mosnjohje paraqesin pengesë të vazhdueshme për rrugën e Kosovës drejt integritimit në BE. Ata poashtu i kanë bërë thirrje Beogradit që mos ta pengojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.

Folësit serbë kanë thënë se më shumë se 60 përqind e popullatës në Serbi përkrahë dialogun e Brukselit. Ata kanë thënë se Serbia dëshiron të shënojë progres më të shpejtë, por është e kushtëzuar në çdo hap me Kapitullin 35 (Kosova). Ata janë ankuar se Beogradi është në tryzni më të madhe se Prishtina, dhe kanë shtuar se “Prishtina nuk është duke e respektuar në plotni frymën dhe dispozitat e marrëveshjes së Brukselit”. Një folës serb ka thënë se dialogu është duke fituar përkrahje në Serbi, por është duke e humbur përkrahjen në Kosovë, duke marrë parasysh një numër protestash në Prishtinë kundër dialogut.

Serbia është futur në dialog, para së gjithash për ta avancuar procesin e saj integruar në BE, kurse Kosova për t'i integruar komunat e saja veriore. Folësit nga Kosova janë ankuar se BE-ja ka qenë mjaft dorëshliërë karshi Serbisë, pasiqë “nuk i kushtëzon negociatat me heqjen e Kosovës nga kushtetuta e Serbisë”. Një diskutues ka shtuar se Serbia shpërblehet më shumë se Kosova: Serbia e ka marrë statusin e kandidatit dhe hapjen e negociatave, kurse Kosova nuk ka marrë as integritimin e veriut. “Kosova është paksa e zhgënjyer me BE-në”. Marrëveshja ishte arritur në vitin 2013, dhe dy vite më vonë implementimi ende mbetet prapa. “Le të mos vazhdojmë me manipulimin e njëri tjetrit dhe komunitetit ndërkombëtar”, ka vazhduar ky folës, duke përfunduar se “nëse një dialog i tillë i zbrazët vazhdon për një kohë të gjatë, ai do ta humbë gjithë përkrahjen e opinionit publik”.

Serbia ka përparuar me shpejtësi rekorde drejt integritimit evropian, ka thënë njëri nga folësit ndërkombëtar. Sipas planit të veprimit, Marrëveshja e Brukselit duhet të jetë implementuar në fund të vitit 2013. “Por energjia, transparenca e mjeteve financiare, telekomunikimi, gjykatat, asnjëra nga këto nuk janë implementuar”. Serbia ende ka institucionet e saja paralele në Kosovë, dhe disa kryesues të këtyre institucioneve janë rriemrëruar rishtas. Ai ka thënë se “statusi i kandidatit i është dhënë Serbisë me besimin që ajo do ta implementojë marrëveshjen në plotni dhe në afatet e parapara kohore”.

Serbët e Kosovës dhe pjesëmarrësit serbë kanë pasur konsensus rreth asaj se Asociacioni/Komuniteti duhet të jetë institucion politik me kompetenca thelbësore ekzekutive në

arsim, shëndetësi, planifikim urban dhe zhvillim ekonomik. Disa folës kanë shkuar më tej, duke propozuar që ky institucion poashtu duhet të mbledhë taksa, përgjegjësi kjo e veçuar për qeverinë qendrore dhe komunat. Pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës kanë thënë se Asociacioni/Komuniteti duhet të bazohet në Marrëveshjen e Brukselit, e cila sipas tyre parasheh rol mbikqyrës dhe vëzhgues në arsim, shëndetësi, planifikim urban dhe zhvillim ekonomik.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian mbetet një aspiratë e fuqishme, si e Serbisë ashtu edhe e Kosovës. Përveç reformave të rregullta, Serbia duhet t'i adresojë edhe marrëdhëniet e saja me Kosovën. Përfaqësuesit ndërkombëtarë kanë shpjeguar se edhe nëse Serbia i përmbush të gjitha kushtet, anëtarësimi i Serbisë në BE do të varet nga zgjidhja e mosmarrëveshjeve me Kosovën. Implementimi i marrëveshjes së Brukselit, apo siç e ka quajtur njëri nga folësit “Brukseli – I”, do të jetë e mjaftueshme për të hapur negociatat mbi kapitujt, por jo edhe për anëtarësim të plotë. Do të ketë edhe “Bruksel II e III” sa më shumë që Beogradi i afrohet anëtarësimit. Pjesëmarrësit janë pajtuar që, përkundër mosmarrëveshjeve rreth statusit, Beogradi dhe Prishtina nuk duhet ta pengojnë njëri tjetrin në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE. Nëse nuk mund ta ndihmojnë njëri tjetrin, atëherë së paku nuk do të duhej t'i bënin dëm njëri tjetrit.

Parime dhe rekomandime për vazhdimin e dialogut të Brukselit

Në korrik të vitit 2015, CIG ka organizuar një punëtori në Arandjelovac, Serbi, për një grup të vogël të përfaqësuesve politikë dhe analistëve nga Serbia dhe Kosova. Dita e parë e diskutimeve ka përfshirë politikanë dhe analistë, kurse dita e dytë vetëm analistët. Bazuar në diskutimet e mëparshme, ata kanë draftuar një numër propozimesh rreth krijimit të Asociacionit/Komunitetit. Dhjetë ditë më vonë, këto rekomandime janë diskutuar në Bruksel, në një tryezë të organizuar nga CIG me zyrtarë të lartë qeveritarë të Kosovës e Serbisë, dhe zyrtarë të BE-së, të cilët, me disa ndryshime të vogla, i kanë përkrahur këto rekomandime.

Parime udhëheqëse

- Asociacioni/Komuniteti duhet të shërbejë si shtytës i integritetit të serbëve të Kosovës në jetën politike dhe publike të Kosovës. Ky institucion do të duhej ta plotësonte punën e serbëve të Kosovës në institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës, e jo t'i marrë përgjegjësitë e tyre.
- Beogradi dhe Prishtina duhet t'i bëjnë kompromiset e nevojshme për arritjen e një marrëveshjeje e cila i kënaq të dyja kryeqytetet, por e cila para së gjithash adreson brengat e komunave me shumicë serbe në Kosovë.
- Veriu i Kosovës ka funksionuar jashtë sistemit të Kosovës për 16 vite, prandaj integrimi i tij duhet të jetë gradual dhe në faza. Krijimi i Asociacionit/Komunitetit të dhjetë komunave me shumicë serbe është një nga fazat e para drejt këtij integrimi.
- Edhe pse Prishtina dhe Beogradi janë duke e negociuar mandatin e Asociacionit/Komunitetit, ky institucion do të duhej të ishte një organ autentik i serbëve të Kosovës. Përfaqësuesit serbë të Kosovës duhet të vendosin rreth aktiviteteve të tij dhe t'i caktojnë strukturat e tij udhëheqëse. Beogradi duhet të lejohet të ofrojë financim për Asociacionin/Komunitetin, por jo edhe ta drejtojë atë.
- Prishtina dhe Beogradi duhet të bëhen akterë më seriozë dhe të besueshëm në procesin e dialogut, duke e përkrahur në mënyrë të vërtetë implementimin e marrëveshjeve sipas afateve kohore të parapara.

- Prishtina dhe Beogradi, të përkrahur nga BE-ja, duhet të japin deklaratatë të përbashkëta pas arritjes së marrëveshjeve dhe të ofrojnë interpretime koherente para opinionit të tyre publik. Interpretimet kundërtëuese të marrëveshjeve shpeshherë kanë prodhuar huti e cila ka kontribuar që të ketë vonesa në procesin e implementimit.
- Beogradi dhe Prishtina duhet ta ushqejnë shpirtin e dialogut dhe të vazhdojnë atë derisa të arrihet normalizimi i plotë. Ata poashtu duhet të fillojnë të marrin parasysh çështjet tjera në një dialog të drejtpërdrejt, pa lehtësimin ndërkombëtar. Takimet bilaterale të zyrtarëve të Kosovës dhe Serbisë, në nivele të ndryshme, duhet të ndodhin më shpesh.

Rekomandime

1. Rekomandime për Qeverinë e Kosovës

- Të krijohet një mekanizëm për udhëheqjen dhe intensifikimin e implementimit të Marrëveshjes së Brukselit. Ky organ do të duhej të ishte zyre në Qeverisë së Kosovës dhe të funksionojë në bashkëpunim të drejtpërdrejt me zyrën e BE-së në Prishtinë.
- Të intensifikohen marrëdhëniet dhe komunikimi me serbët e Kosovës.
- Të ofrohet përkrahje e plotë për Asociacionin/Komunitetin që ta ndihmojë në arritjen e kapaciteteve në pajtim me marrëveshjen që pritet të arrihet.
- Asociacioni/Komuniteti duhet të pranohet dhe të përkrahët nga Qeveria e Kosovës.
- Qeveria e Kosovës duhet të marrë përgjegjësinë e cila i takon komunitetit shumicë, dhe ta udhëheqë një proces gjithëpërfshirës të marrëdhënieve me publikun, me qëllim të transformimit të diskursit kah akomodimi më i gjërë i serbëve në Kosovë.

2. Rekomandime për Qeverinë e Serbisë

- Qeveria e Serbisë duhet ti përkrahë serbët e Kosovës që të marrin më shumë përgjegjësi rreth implementimit të marrëveshjeve të arritura.
- Në proceset zgjedhore të ardhshme në Kosovë, Qeveria e Serbisë do të duhej të ndihmonte që të garantohet respektimi i principeve të pluralizmit demokratik për serbët e Kosovës.
- Qeveria e Serbisë duhet ta shohë Kosovën funksionale si diçka në interes të vetin, dhe në pajtim me këtë, ta ndryshojë diskursin publik brenda shoqërisë serbe.
- Me tu arritur marrëveshja për Asociacionin/Komunitetin, implementimi i saj dhe shpërbërja e institucioneve paralele duhet të ndodhin në të njëjtën kohë, në mënyrë paralele. Punësimi i rreth 5,000 personave të cilët për momentin janë të punësuar në sistemin paralel do të jetë sfida kryesore.

3. Rekomandime për serbët e Kosovës

- Serbët e Kosovës duhet të kenë zë më të fuqishëm dhe angazhim më të madh në formësimin dhe implementimin e marrëveshjeve të arritura.
- Përfaqësuesit serbë në institucionet e Kosovës duhet të angazhohen aktivisht në procesin e implementimit të marrëveshjeve, si dhe në promovimin e të kuptuarit më mirë të procesit nga ana e komunitetit serb në Kosovë.
- Përfaqësuesit serbë duhet të krijojnë marrëdhënie më të mira pune përbrenda institucioneve të Kosovës, si dhe të intensifikojnë përfshirjen e tyre të përgjithshme në përmirësimin e bashkëpunimit ndëretnik.

- d. Serbët e Kosovës, posaçërisht ata në institucionet e Kosovës, duhet ta përkrahin tërësisht implementimin e marrëveshjeve të arritura, me theks të veçantë marrëveshjet mbi gjykatat dhe Asociacionin/Komunitetin.

4. Rekomandime për Bashkimin Evropian

- a. BE-ja duhet të marrë një rol më proaktiv në dialog dhe në implementimin e marrëveshjeve, pra një rol më të madh se sa ate të lehtësuesit.
- b. BE-ja duhet të kontribuojë jo vetëm në normalizimin e marrëdhënieve mes qeverive, por edhe mes shoqërisë shqiptare e asaj serbe, duke përkrahur dialogjet mes shoqërive civile të Kosovës e Serbisë.
- c. BE-ja, së bashku me të dy qeveritë duhet që në mënyrë aktive të shpërndajë informata rreth sfidave dhe produkteve të dialogut, dhe ta inkurajojë popullatën që ta kuptojë drejt dhe ta përkrahë dialogun.
- d. BE-ja duhet të provojë ta bëjë dialogun e Brukselit më përfshirës duke punuar me publikun e gjërë dhe duke diskutuar normalizimin me sektorët e tjerë të shoqërive të Kosovës dhe Serbisë, duke marrë parasysh qëndrimet e tyre ndaj procesit.
- e. Kurdo që është e mundur, BE-ja duhet të ofrojë fonde për të përkrahur integrimin e veriut në institucionet e Kosovës dhe përmirësimin e perspektivës ekonomike.
- f. Plani i implementimit duhet të rivlerësohet.
- g. BE-ja duhet ta konsiderojë mundësinë e përfshirjes së pajtimit si njëra nga temat e dialogut.

A janë normalizimi i marrëdhënieve dhe integrimi evropian të ndërlidhura?

Për ta adresuar procesin e integritit evropian të Serbisë dhe Kosovës, si dhe dialogun mes tyre, në korrik të vitit 2015, CIG ka organizuar në Bruksel një tryezë të rrumbullakët për një grup të vogël të zyrtarëve të lartë qeveritarë nga Kosova dhe Serbia, si dhe një numër zyrtarësh të BE-së.

Dialogu mes Prishtinës dhe Beogradit është i ndërlidhur me perspektivën e tyre të integritit evropian. Këto dy procese mund ta ndihmojnë apo bllokojnë njëri tjetrin. Pjesëmarrësit janë pajtuar se një dialog i suksesshëm do të përshpejtonte integrimin e tyre evropian, kurse perspektiva e qartë e integritit evropian do të shërbente si nxitës për dialog dhe kompromis. Një folës nga Beogradi ka thënë se BE-ja do të duhej të ofronte një udhërrëfyes më të qartë për anëtarësimin e shteteve të Ballkanit. Deklaratat e fundit nga zyrtarët e BE-së se procesi i zgjerimit do të mbetet i ngrirë për një kohë nuk kanë ndihmuar aspak.

Beogradi dhe Prishtina janë në faza të ndryshme sa i përket procesit të integritit në BE, por megjithatë mund të bashkëpunojnë në shumë fusha. Pjesëmarrësit nga Beogradi dhe Prishtina janë pajtuar të vendosin bashkëpunimin si në nivelin politik, ashtu edhe në ate teknik mes institucioneve të Kosovës dhe Serbisë, të cilat merren me integrimet evropiane. Janë identifikuar edhe një numër fushash ku mund të bashkëpunohet: bashkëpunimi në përkthimin e *Acqui-së*, bashkëpunimi rreth planit të veprimit për zbatimin e *Acqui-së*, si dhe në disa projekte të financuara përmes IPA-s.

Një tjetër folës ka thënë se odat ekonomike të Serbisë dhe Kosovës, së bashku me Eurochambers kanë lansuar një proces ku është arritur një përparim thelbësor. Tashmë janë arritur marrëveshje

mbi shërbimet postare dhe hekurudhat, ndërsa ekziston interesi i përbashkët për vendosjen e linjës së rregullt të fluturimeve mes Prishtinës e Beogradit. Ky folës ka thënë se bashkëpunimi mund të zgjerohet edhe më tej, duke punuar së bashku përmes projekteve të IPA-s. Njëri nga propozimet konkrete ka qenë riparimi i tunelit hekurudhor në Merdare, në mënyrë që të mund të fillojë shërbimi i trenave mes Beogradit e Prishtinës. Një propozim tjetër ka qenë shkëmbimi i zyrtarëve ndërlidhës të ekonomisë dhe tregtisë.

Përderia pjesëmarrësit nga Kosova dhe Serbia kanë kërkuar angazhim më intenziv të BE-së në dialog, përfaqësuesit e BE-së kanë thënë se Prishtina dhe Beogradi do të duhej të marrin më shumë përgjegjësi mbi vete, dhe të mbështeten më pak tek BE-ja. Kjo së pari do të tregonte se Prishtina dhe Beogradi janë të afta të zgjidhin mosmarrëveshjet mes tyre, dhe së dyti, shefja e re e politikës së jashtme të BE-së ka shumë më pak kohë për t'u angazhuar në çështjet e Ballkanit, krahasuar me paraardhësen e saj. Beogradi dhe Prishtina duhet të gjejnë një mënyrë tjetër të bashkëpunimit e cila mbështetet më pak tek akterët tjerë. Një tjetër zyrtar ndërkombëtar ka thënë se motivi kryesor i Serbisë dhe Kosovës për përparim dhe zhvillim nuk do të duhej të ishte anëtarësimi në BE, por përmirësimi i jetës së qytetarëve.

BE-ja tashmë ka ofruar mjaft stimuj për Serbinë dhe Kosovën, dhe ka qenë e qartë në kërkesat e saj të cilat duhet përmbushur në mënyrë që të konsiderohet mundësia e anëtarësimit. Përfaqësuesit e BE-së kanë thënë se edhe Serbia e Kosova do të duhej të ofronin stimuj për BE-në, të tregonin se janë partnerë të denjë. Serbia dhe Kosova kanë qenë konstruktive në marrëdhëniet e tyre prej fillimit të dialogut, por BE-ja dhe shtetet anëtare janë duke pritur më shumë rezultate dhe përkushtim para hapjes së kapitujve me Serbinë. Një përfaqësues i BE-së ka thënë se BE-ja është duke u frustruar gjithnjë e më shumë. Nëse Prishtina dhe Beogradi dëshirojnë të dëshmojnë se janë akterë serioz, ata duhet të tregojnë “rezultate, e jo vetëm diskutime konstruktive”.

Serbia dhe Kosova kanë përgatitur raportet e tyre të veçanta të vlerësimit, dhe disa folës kanë thënë se edhe BE-ja do të duhej të hartonte raporte të tilla. Si përfaqësuesit e Beogradit, poashtu edhe ata të Prishtinës kanë thënë se një mekanizëm i tillë i vlerësimit do të ndihmonte. Pjesëmarrësit kanë thënë se BE-ja do të duhej të kishte qasje me bazë meritore në dialog, t'i shpërblejë ata të cilët bashkëpunojnë, dhe t'i ndëshkojë ata të cilët nuk bashkëpunojnë. Megjithatë, niveli i implementimit mbetet i hapur për interpretime, dhe përfaqësuesit e BE-së frikësohen se një qasje e tillë do të mund ta rrezikonte neutralitetin e tyre në rolin e ndërmjetësuesit. Përfaqësuesit e Prishtinës dhe Beogradit kanë rekomanduar që zyrtarët e BE-së të angazhohen në interpretimin e marrëveshjeve, dhe ndonjëherë të marrin rol të arbitrit në rastet kur procesi i implementimit bllokohet. Pjesëmarrësit kanë përmyllur diskutimet me pikat në vazhdim:

- Përfaqësuesit e Prishtinës dhe Beogradit kanë propozuar organizimin e një takimi të stafit teknik dhe politik të organeve qeveritare të Kosovës e Serbisë të cilat merren me integrimet evropiane. Qëllimi i takimit do të ishte shkëmbimi i përvojave, mësimet e nxjerra, dhe bashkëpunimi në projekte, strategji dhe plane të veprimit të kërkuara nga BE-ja. Bashkëpunimi rreth përkthimit në gjuhën serbe të *Acqui*-së është shembull i një fushe të bashkëpunimit. Për më shumë, ata poashtu kanë propozuar shkëmbim të stafit, një program të

përbashkët edukativ mbi integrimin evropian, dhe një fushatë të përbashkët në luftimin e imazhit negativ të Ballkanit perendimor në BE.

- Serbët e Kosovës do të duhej të përfshiheshin në procesin e integrimit evropian të Kosovës. Integrimi evropian kërkon reforma të ndryshme në nivelin lokal, dhe kjo është njëra nga fushat ku kryetarët e komunave me shumicë serbe do të mund të angazhoheshin më shumë. Me qëllim të inkurajimit të kryetarëve të komunave me shumicë serbe që të marrin pjesë në proces, do të duhej organizuar takime të përbashkëta të përfaqësuesve të Prishtinës dhe Beogradit me kryetarët e komunave. Shumë nga folësit kanë thënë se angazhimi në procesin e integrimit evropian është më pak i ndjeshëm dhe se do të mund të kishte efekt pozitiv në integrimin e serbëve të Kosovës në jetën publike të Kosovës, si dhe do të përmirësonte marrëdhëniet e përgjithshme ndëretnike.
- BE-ja, Prishtina dhe Beogradi duhet të krijojnë një mekanizëm të përbashkët i cili vlerëson respektimin nga ana e të gjithë akterëve të marrëveshjeve dhe afateve kohore të implementimit të dialogut të Brukselit.
- Marrëveshjet e ardhshme duhet të jenë më specifike. Paqartësia ka qenë mjaft e dobishme për iniciimin e dialogut dhe arritjen e marrëveshjeve në një kohë kur përfaqësuesit e Prishtinës dhe Beogradit nuk kanë qenë të gatshëm as t'ia shtrijnë dorën njëri tjetrit. Por tani që dialogu ka lëvizur në një fazë tjetër dhe barrierat fillestare janë eliminuar, marrëveshjet duhet të kenë specifika të qarta dhe afate kohore. Poashtu, BE-ja duhet t'i shpërblejë ata që bashkëpunojnë dhe t'i ndëshkojë të cilët nuk bashkëpunojnë. Një sistem i bazuar në merita i shpërblimeve dhe ndëshkimeve do t'i inkurajontë të dyja palët që t'u përmbahen angazhimeve të tyre. Për më shumë, BE-ja do të duhej t'u ofronte palëve një drejtim më të qartë se ku dëshiron ta shpie tërë procesin.

Dialogu i Brukselit: hapat e rradhës dhe sfidat në të ardhmen

Në nëntor të vitit 2015, CIG ka organizuar në Vjenë të Austrisë një tryezë të rumbullakët për zyrtarët e lartë qeveritarë të Kosovës dhe Serbisë, dhe zyrtarët zivcranë dhe ata të BE-së, për të diskutuar hapat e mëtejme në dialog, si dhe implementimit e marrëveshjeve. Ky ka qenë takimi i vetëm i negociatorëve të Kosovës e Serbisë në çerekun e fundit të vitit 2015. Dialogu është duke e humbur përkrahjen në Kosovë, ku partitë politike opozitare fuqishëm e kundërshtojnë krijimin e Asociacionit/Komunitetit, duke bllokuar punën e parlamentit, dhe duke organizuar protesta në rrugë. Gjykata Kushtetuese e Kosovës është duke e rishikuar legalitetin e Asociacionit/Komunitetit. Deri atëherë, ekipi i ngarkuar me detyrën e hartimit të statutit nuk do të mund të formohet, edhe pse disa folës kanë thënë se ekipi menaxhues do të mund të fillonte punën. Ka vonesa në implementimin e marrëveshjeve tjera, siç janë ato për integrimin e strukturave gjyqësore në veri, si dhe huti në lidhje me disa marrëveshje tjera, siç është mbyllja e këshillave të përkohshëm komunal, të cilat nuk janë adresuar në Marrëveshjen e Brukselit.

Përkundër disa hapave prapa, pjesëmarrësit kanë konfirmuar zotimin e qeverive të tyre rreth dialogut, por kanë theksuar se dialogu si i tillë ka nevojë për një dinamikë të re, duke përfshirë një komunikim më të mirë mes ekipeve dhe më shumë përkushtim ndërkombëtar, posaçërisht në interpretimin e marrëveshjeve dhe në vlerësimin e progresit të implementimit. Pjesëmarrësit serbë janë fokusuar kryesisht në krijimin e Asociacionit/Komunitetit, kurse folësit nga Kosova kanë thënë se dialogu duhet të ketë një vizion të qartë dhe afate specifike kohore në lidhje me rezultatin përfundimtar. Në vazhdim janë pikat kyçe nga diskutimi:

- Prishtina dhe Beogradi duhet të jenë të përkushtuar në implementimin e Marrëveshjes së Brukselit në tërësi, deri në fund të vitit 2016. Marrëveshja duhet të përfshijë shpërbërjen e institucioneve paralele të mbetura, dhe krijimin e Asociacionit/Komunitetit.
- Takimet bilaterale mes zyrtarëve të Serbisë dhe Kosovës duhet të intensifikohen. Ato duhet të përfshijnë takime mes ministrave, drejtorëve të policive, si dhe punëtorëve profesional të ministrive. Siç ka theksuar njëri nga folësit, “sa më shumë që flasim, as më mirë e kuptojmë njëri tjetrin, dhe aq më pak probleme kemi”. Në këtë kontekst, pjesëmarrësit poashtu kanë propozuar krijimin e një linje të hapur telefonike, “*hotline*”, mes dy zyrave të dy kryeministrave.
- Vendosja e bashkëpunimit në fusha më pak të ndjeshme, siç janë çështjet e integritit evropian. Pjesëmarrësit kanë propozuar që të ketë bashkëpunim në planin e veprimit për implementimin e MSA-së, dhe përkthimin e *Acqui*-së.
- Vazhdimi i dialogut mes Beogradit e Prishtinës është i rëndësishëm, por më i rëndësishëm mbetet stabiliteti i brendshëm. Beogradi dhe Prishtina duhet ti menaxhojnë krizat me durim, dhe ta ruajnë stabilitetin e brendshëm, duke qenë në të njëjtën kohë të përkushtuar ndaj dialogut. Dialogu ka nxitur protesta të fuqishme në Kosovë. Në fillim, në vitin 2011, nën qeverisjen e Partisë Demokratike, dialogu nuk ka qenë aq i popullarizuar në Serbi, kurse në Kosovë ka ekzistuar një konsensus. Kundërshtimi i ndaj dialogut nga partia kryesore në qeveri tani, e atëherë në opozitë, ka qenë i fuqishëm. Tani situata ka ndryshuar diametralisht. Në Serbi ekziston pothuajse konsensus i plotë mes partive qeveritare dhe atyre të opozitës në lidhje me dialogun, kurse në Kosovë një kundërshtim i fuqishëm nga ana e partive opozitare, si dhe skepticizëm nga ana e partive në qeveri.
- Prishtina beson se ekziston një lidhje e drejtpërdrejt mes shpërbërjes së këshillave të përkohshëm komunal dhe krijimit të Asociacionit/Komunitetit. Beogradi thotë se një ndërlidhje e tillë nuk ekziston. Prishtina kërkon shpërbërjen e të gjitha strukturave paralele, përfshirë këshillat e përkohshëm komunal të cilat nuk janë përfshirë në Marrëveshjen e Brukselit, para krijimit të Asociacionit/Komunitetit. Beogradi thotë se këshillat e përkohshëm komunal ofrojnë një numër shërbimesh për serbët e Kosovës, siç është shpërndarja e asistencës sociale, duke sugjeruar kështu që mekanizmat e rinj të jenë funksional para shpërbërjes së këshillave. Folësit nga Kosova kanë thënë se komunat mund t’i ofrojnë këto shërbime. Deri më tani, vetëm Mitrovica Veri është integruar pjesërisht. Tri komunat tjera në veri kanë kryetar komunash dhe asamble të dala nga zgjedhjet e Kosovës, por jo edhe administratë.
- Të krijohet një grup punues për gjetjen e zgjidhjes për shpërbërjen e këshillave të përkohshëm komunal.
- Disa folës kanë thënë se ekipi menaxhues i hartimit të statutit të Asociacionit/Komunitetit do të mund të fillonte punën e tij. Megjithatë, një folës nga Kosova ka thënë se një gjë e tillë mund të mos jetë legale, përderisa Gjykata Kushtetuese të mos ketë marrë vendim për legalitetin e Asociacionit/Komunitetit.
- Beogradi dhe Prishtina duhet të punojnë së bashku në ndërtimin e një narrativi të bazuar në fakte rreth dialogut, me ç’rast do të theksoheshin rezultatet e tij, në vend se të shpenzohet energji në sabotimin e njëri tjetrit. Zyrtarët qeveritarë në Beograd dhe Prishtinë duhet të flasin më shumë me qytetarët e tyre për të mirat e dialogut. Kryeministrat Isa Mustafa dhe Aleksandar Vučić duhet të japin intervista substanciale në mediat e vendeve të njëri tjetrit.

Negociatori kryesor i Serbisë, Marko Đurić do të mund të merrte pjesë në debate televizive të Kosovës. Poashtu, negociatorja kryesore e Kosovës, Edita Tahiri, do të mund të ligjëronte në Beograd. Një komunikim i tillë do t'u ndihmonte qytetarëve ta kuptojnë kompleksitetin e dialogut, por edhe të mirat që dalin nga ai. Duke përdorur faktet për një narrativë pozitive, në këto media dhe shkëmbime publike, zyrtarët do të mund të tregojnë se dialogu i ka të mirat e tij, siç janë heqja e pagesave për sigurimin e veturave, liria e lëvizjes, dhe integrimi i policisë në veri.

- Çështja e statusit rishfaqet kohë pas kohe, dhe vazhdon të mbetet pengesë në dialogun e Brukselit dhe në procesin e normalizimit në përgjithësi.

Në fund, pjesëmarrësit kanë thënë se dialogu nuk është i popullarizuar as në Kosovë e as në Serbi. Në fillim, qëllimi i dialogut është thënë se do të jetë “përshtatja ndaj realitetit”, se serbët e Kosovës do të integrohen në sistemin e Kosovës, por dialogu gjithnjë e më shumë është duke u marrë me çështje të ndjeshme, siç janë telekomunikimi, energjetika, dhe sipas të gjitha gjasave, në të ardhmen do të merret edhe me çështjen e statusit. Shumë nga pjesëmarrësit kanë thënë se hapja e kapitullit 35 në negociatat e Serbisë për anëtarësim në BE do të sjellë një dinamikë të re në dialog. Disa prej pjesëmarrësve kanë thënë se “një marrëveshje ligjrisht obligative” është kusht për përmblylljen e suksesshme të këtij kapitulli.

KRIJIMI I ASOCIACIONIT/KOMUNITETIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE

Krijimi i Asociacionit/Komunitetit është njëra nga çështjet më delikate të Marrëveshjes së Brukselit. Prishtina insiston se Asociacioni/Komuniteti duhet të ketë një rol mbështetës dhe koordinues në punën e komunave me shumicë serbe, por mos t'ua marrë atyre kompetencat ekzekutive. Me fjalë tjera, ai nuk duhet të ketë kompetenca ekzekutive. Beogradi dhe serbët e Kosovës thonë se Asociacioni/Komuniteti duhet të jetë organizatë ombrellë me fuqi vendimmarrëse në fushën e arsimit, shëndetësisë, privatizimit, zhvillimit ekonomik dhe planifikimit hapësinor, si dhe në menaxhimin e kompanive publike. Sipas ligjeve të Kosovës, këto kompetenca janë të rezervuara për autoritetet komunale.

Krijimi i Asociacionit/Komunitetit është drejtpërdrejt i lidhur me shpërbërjen e institucioneve paralele të Serbisë, në të cilat, sipas zyrtarëve serbë, janë të punësuar 5,085 persona. Ata thonë se Beogradi nuk mund ta shpërbëjë sistemin paralel pa u gjetur së pari vende pune shumicës prej tyre. Sipas disa folësve, Beogradi më nuk është duke e përkrahur sistemin paralel për qëllime politike, por për qëllime praktike. Largimi nga puna i mijëra njerëzve brenda natës do të mund të krijonte një reaksion negativ i cili do të shënonte një hap prapa një procesin e integritetit.

Përfaqësuesit serbë kanë thënë se Asociacioni/Komuniteti do të mund të akomodohej brenda kornizës ligjore të Kosovës, pa amandamente kushtetuese. Ata kanë thënë se qëllimi i Asociacionit/Komunitetit është përmirësimi i pozitës politike të serbëve të Kosovës. Përfaqësuesit e Kosovës kanë dyshime rreth qëllimeve të Beogradit. Shumë prej folësve kanë thënë se arsyeja kryesore prapa krijimit të Asociacionit/Komunitetit nuk është përmirësimi i pozitës së serbëve, por minimi i sistemit të Kosovës..

Pengesat kryesore në krijimin e Asociacionit/Komunitetit

CIG ka organizuar në dhjetor të vitit 2014, ne Budvë të Malit të Zi, një tryezë të rrumbullakët për zyrtarët qeveritarë, përfaqësuesit e partive politike dhe anëtarët e shoqërisë civile nga Kosova e Serbia. Pjesëmarrësit kanë listuar një numër pengesash të cilat janë duke e vonuar krijimin e Asociacionit. Shumë folës nga Kosova e kanë bërë përgjegjës Beogradin dhe institucionet e mbetura paralele në veri për vonesat në implementimin e Marrëveshjes së Brukselit, pjesë e së cilës është edhe Asociacioni. Folësit serbë kanë thënë se vonesa ka ndodhur kryesisht për shkak se Prishtinës i janë dashur gjashtë muaj për të formuar qeverinë e re.

Lista Srpska është pjesë e koalicionit qeverisës, dhe mban dy ministri dhe një post të zëvendëskryeministrit, por ka kushtëzuar hyrjen në këtë koalicion me disa kushte, ku njëra prej tyre është që Asociacioni të formohet brenda pesë muajve të parë të qeverisjes. Shumë prej pjesëmarrësve kanë thënë se Lista Srpska duhet të marrë mbi vete më shumë përgjegjësi, pasi që tani udhëheq Minsitrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Ka ekzistuar konsensus mes pjesëmarrësve se Marrëveshja e Brukselit nuk është duke u implementuar sipas afateve kohore të parapara. Por përderisa pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës e kanë fajësuar Beogradin, kryetarët e rinj të komunave dhe institucionet e mbetura paralele në veri të Kosovës, siç janë të ashtuqujturat mbrojtja civile dhe organet “e përkohshme” ekzekutive komunale serbe, folësit serbë kanë thënë se Prishtina e ka bllokuar procesin duke mos qenë e gatshme të bëjë kompromiset e nevojshme për të shkuar më tej me implementimin. Asociacioni ishte pritur të krijohet pas krijimit të komunave në veri. Një vit pas zgjedhjeve, administratat komunale nuk janë ende funksionale, dhe nuk ekziston ende as statuti për Asociacionin.

Komunat nuk janë duke funksionuar dhe ende nuk ofrojnë shërbime. Krijimi i Asociacionit nuk do të duhet të ishte shumë i vështirë. Komunat formojnë Asociacionin, por komunat duhen së pari të jenë funksionale në mënyrë që të formojnë Asociacionin. Një folës nga Kosova ka thënë se fondi zhvillimor për veriun, i krijuar si pjesë e marrëveshjes së Brukselit, ka mbledhur rreth 3 milion euro, por komunat nuk mund t'i shfrytëzojnë këto fonde përderisa të mos jenë vetë plotësisht funksionale. Për më shumë, qeveria e Kosovës u ka ofruar 49 milion euro katër komunave në veri. Komunat i kanë refuzuar fondet për “arsye politike”. Shpenzimet më të mëdha komunale janë në arsim dhe shëndetësi. Megjithatë, autoritetet komunale konsiderojnë se përgjegjësia për këta dy sektorë do të duhet të binte mbi Asociacionin, e jo mbi komunat. Si rrjedhojë e kësaj, buxheti i tanishëm i adoptuar nga katër komunat është 7 milion euro.

Një folës serb ka thënë se Asociacioni do të duhet të ishte organ qeveritar me kompetenca solide. Ai ka thënë se serbët në veri nuk do të heqin dorë nga institucionet e mbetura paralele pa pasur një Asociacion i cili ka përgjegjësi të fuqishme. Ai ka shtuar se Kosova duhet ta amandamentojë kushtetutën e saj për ta akomoduar Asociacionin. Folësit e Kosovës kanë refuzuar këtë ide dhe kanë thënë se Asociacioni duhet t'i përshtatet kushtetutës së Kosovës. “Nëse është aq e lehtë të ndryshohet kushtetuta, atëherë pse nuk e ndryshon Serbia kushtetutën e saj?” ka pyetur njëri nga folësit.

Kosova tashmë ka hequr dorë mjaft në procesin e dialogut, ka thënë një tjetër folës nga Kosova. Ai ka thënë se Marrëveshja e Brukselit është në kundërshtim me kushtetutën e Kosovës, por

zyrtarët e Kosovës janë pajtuar me të si rezultat i trysnisë ndërkombëtare. Krijimi i shtresave të reja të institucioneve nuk e përmirëson jetën e serbëve në Kosovë. “Serbët në Kosovë nuk mërzhiten fort për krijimin e institucioneve të reja kur shohin se nuk ka kurrfarë përmirësimi në terren dhe janë çdo ditë e më të varfër”. Për më shumë, krijimi i Asociacionit është i bazuar në parimin e segregimit dhe promovon ndarje, pasi që përfshin vetëm komunat me shumicë serbe. Tani do të jenë dy asociacione të komunave, njëra e komunave me shumicë shqiptare, dhe tjetra e komunave me shumicë serbe. “Nuk ekziston ndonjë term tjetër për këtë gjë përveç segregimit”, ka thënë ky folës.

Një folës serb nga Kosova ka thënë se tema kryesore e Marrëveshjes së Brukselit ka qenë Asociacioni i komunave me shumicë serbe, por sot e kësaj dite, Prishtina dhe Beogradi nuk kanë dhënë asnjë propozim. Beogradi duket se nuk është duke punuar aspak në këtë drejtim, kurse Prishtina ka formuar një ekip prej katër personash që nuk kanë bërë ende asgjë. Ai ka thënë se Asociacioni duhet të jetë përgjegjës për arsimin dhe shëndetësinë, fusha këto të cilat për momentin administrohen nga Beogradi. Megjithate, në bazë të ligjeve të Kosovë, këto fusha bëjnë pjesë në kompetencat komunale. Ai ka konkluduar se Asociacioni do të bëhet organ politik, dhe jo organizatë joqeveritare, siç është Asociacioni ekzistues i Komunave.

Përkundër shumë sesioneve të dialogut në Bruksel dhe një numri marrëveshjesh, jetërat e njerëzve nuk janë përmirësuar, dhe ky është shkaku pse dialogu shihet si i padobishëm. Dhe perceptimet janë të rëndësishme pasi ato shëndrrohen në veprime. “Ne të gjithë themi se viti i kaluar ka qenë i suksesshëm në marrëdhëniet mes Kosovë e Serbisë, por ky sukses nuk i ka prekur njerëzit”, ka thënë një folës i cili e njih për së afërmi procesin e implementimit. “Përkundër kritikave të mia të vazhdueshme, unë e mbështes dialogun sepse ai është i vetmi mekanizëm për zgjidhjen e problemeve të pazgjidhura me Serbinë”, ka thënë një folës nga Kosova. Megjithate, ai nuk do ta përkrahë dialogun nëse ai shkel rendin kushtetues të Kosovës. Ai ka thënë se legjislacioni i Kosovës njih organe qeveritare dhe joqeveritare, por nuk ka mundësi që Asociacioni të mos jetë as njëra e as tjetra.

Në lidhje me largimin eventual nga puna të qindra të punësuarve në institucionet e stërrmbushura paralele, ai ka propozuar që Beogradi t’i subvencionojë ata të cilët do të duhet të largohen nga puna në veri. Ai ka qenë kundër idesë që Asociacioni t’ua shpërndajë pagesat këtyre personave. Ai poashtu ka thënë se komunat duhet t’i paguajnë mësuesit dhe mjekët. “Është e rrezikshme ti lihet Asociacionit kontrolli i drejtpërdrejt mbi mijëra të punësuar”. Ky folës ka thënë se Asociacioni do të ketë një rol më të fuqishëm se këshilat ekzistues të minoriteteve në Serbi. Një tjetër folës ka shtuar se nëse Beogradi dëshiron të tregojë se çfarë qëllimi dëshiron të arrijë me Asociacionin, atëherë le ta tregojë këtë më një shembull, duke u dhënë të njejtat të drejta shqiptarëve në jug të Serbisë dhe minoriteteve tjera në pjesë tjera të Serbisë.

Një folës ka theksuar se Beogradi dëshiron që Asociacioni të bëhet shtresa e tretë e qeverisë, dhe ka shtuar se “kur ke kontroll mbi çeshtjet financiare, atëherë je organ qeveritar”. Decentralizimi do të duhej të ishte i mjaftueshëm për të akomoduar serbët në Kosovë. “Srpska nuk e ka pasur as edhe një takim të vetëm me serbët e Kosovë. Përfaqësuesit e saj gjithmonë shkojnë në Beograd për konsultime. Rrjedhimisht, Asociacioni nuk do t’i përfaqësojë serbët e Kosovës, por Beogradin”. Ai ka thënë se interesat e Beogradit dhe serbëve të Kosovë nuk janë gjithmonë të njejtat. Ky folës ka kërkuar që të flitet për të gjithë qytetarët e Kosovës, jo vetëm për serbët. “Ne

flasim se si ta zgjidhim çështjen e papunësisë në mesin e serbëve, por jo edhe në mesin e komuniteteve të cilat kanë edhe më shumë papunësi”. Ai ka shtuar se edhe nëse Kosova i ndryshon ligjet e saj dhe kushtetutën, “një gjë e tillë nuk do të përmirësojë integrimin e serbëve të Kosovës, por thjesht do të legalizojë një mekanizëm serb të ndërhyrjes në sistemin e Kosovës”.

Duke u pergjigjur në pyetjen se pse serbët janë kundër planit të Ahtisarit, por janë pro Marrëveshjes së Brukselit, një folës serb ka thënë se kjo e fundit është neutrale ndaj statusit. Megjithate, një tjetër folës nuk është pajtuar më këtë, duke thënë se Marrëveshja është e bazuar sistemin e Kosovës, dhe se Asociacioni ka qenë justifikimi i Beogradit për të pranuar përfundimisht pakon e Ahtisarit. Ai ka shtuar se parakushtet për krijimin e Asociacionit janë largimi i strukturave paralele dhe funksionimi i sistemit ligjor të Kosovës në veri. Përkundër shumë mosmarrëveshjeve rreth mandatit të Asociacionit, ka ekzistuar një pajtim i gjërë se krijimi i Asociacionit dhe shuarja graduale e strukturave paralele do të jenë procese paralele.

Asociacioni/Komuniteti dhe sistemi paralel

CIG ka organizuar një numër aktivitete në shkurt të vitit 2015 në Graçanicë, Prishtinë dhe Stamboll, rreth krijimit të Asociacionit/Komunitetit dhe shpërbërjes së Mbrojtjes Civile (MC) në veri të Kosovës. Përderisa ka ekzistuar një konsensus mjaft i qëndrueshëm mbi shpërbërjen e MC-së, pjesëmarrësit kanë pasur qëndrime diametralisht të kundërta rreth mandatit të Asociacionit/Komunitetit.

Gjashtë nga pesëmbëdhjetë pikat e Marrëveshjes së Brukselit kanë të bëjnë me krijimin e Asociacionit. Edhe pse marrëveshja lë hapësirë për më shumë se një interpretim të vetëm, folësit shqiptarë të Kosovës kanë thënë se megjithate është mëse e qartë se Marrëveshja nuk parasheh çfarëdo kompetence ekzekutive. Por serbët e Kosovës dhe folësit nga Beogradi kanë thënë se një Asociacion pa fuqi ekzekutive është i pakuptimtë. Për më shumë, serbët insistojnë që Asociacioni të formohet para shpërbërjes së sistemit paralel dhe implementimit të marrëveshjes, përfshirë edhe ate mbi gjykatat në veri. Folësit shqiptarë të Kosovës thonë se Asociacioni do të mund të formohej vetëm pasi Serbia ta ketë shpërbërë sistemin e saj paralel në Kosovës.

Për çfarë Asociacioni/Komuniteti kanë nevojë serbët e Kosovës?

Pjesëmarrës në tryezën e rrumubullakët në Graçanicë kanë qenë kryetarët e komunave me shumicë serbe, anëtarët e partive politike të serbëve të Kosovës, dhe përfaqësuesit serbë të shoqërisë civile. Pjesëmarrësit kanë pasur qëndrim të përbashkët se Asociacioni do të duhej të ishte organizatë politike me fuqi ekzekutive në arsim, shëndetësi, planifikim urban dhe zhvillim ekonomik. Disa folës i kanë shtuar kësaj liste edhe ndonjë formë të mbledhjes së taksave – taksë të shitjes dhe TVSH – kompetencë kjo e institucioneve qendrore dhe komunale të Kosovës.

Sfida kryesore në krijimin e Asociacionit do të jetë përmbushja e pritjeve të serbëve të Kosovës dhe Beogradit për një institucion të fuqishëm, dhe propozimeve të shqiptarëve të Kosovës për një institucion me rol thjesht koordinues, si dhe në përmbushjen e gjashtë pikave të Marrëveshjes së Brukselit rreth Asociacionit. Më poshtë janë pikat kryesore nga diskutimi në Graçanicë.

- Asociacioni duhet të ketë fuqi ekzekutive në katër fushat e përfshira në Marrëveshjen e Brukselit, dhe duhet të financohet nga Beogradi. Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar do të mund të kontribuonin në buxhetin e tij, por nuk do të kishin fuqi vendimmarrëse rreth shpenzimeve.
- Asociacioni duhet të shërbejë si forum për të diskutuar dhe artikuluar interesat serbe dhe të përfaqësojë e unifikojë komunitetin serb në Kosovë. Si forum për diskutim, Asociacioni do të kontribuonte poashtu në pluralizmin politik brenda serbëve të Kosovës.
- Kryetarët e komunave me shumicë serbe duhet të përfshihen në diskutimet mbi draft statutin e Asociacionit, pasi që ata do të jenë përfaqësuesit kryesorë të tij. Disa nga kryetarët e komunave kanë thënë se as Prishtina e as Beogradi nuk janë konsultuar me ta.
- Sistemet e arsimit dhe shëndetësisë në shërbim të serbëve të Kosovës, përfshirë edhe planprogramet dhe financat e Serbisë, duhet të mbesin brenda sistemit të Serbisë dhe duhet të menaxhohen nga Asociacioni, përfshirë këtu edhe shpërndarjen e pagave. Megjithatë, disa prej pjesëmarrësve kanë thënë se mund të jetë kundërproduktive nëse një organizate politike i jepen shumë kompetenca mbi arsimin.

Çfarë Asociacioni/Komuniteti është i mundshëm sipas Marrëveshjes së Brukselit?

Pjesëmarrës në tryezën e rrumbullakët në Prishtinë kanë qenë anëtarët e partive politike të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, anëtarë të parlamentit, zyrtarë të lartë qeveritarë, dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Folësit shqiptarë të Kosovës kanë mbajtur qëndrimin se Asociacioni/Komuniteti do të krijohet në pajtim me ligjet e Kosovës, dhe si i tillë ai nuk do të ketë fuqi ekzekutive apo mbikqyrëse, por vetëm rol koordinues. Ata kanë shpjeguar se roli i Asociacionit/Komunitetit është thjesht për të “mbikqyrur”, term ky i përdorur në Marrëveshjen e Brukselit, katër fushat e cekura. Folësit serbë të Kosovës, në anën tjetër, kanë thënë se Asociacioni duhet të ketë kompetenca ekzekutive në këto katër fusha, si dhe të mbledhë TVSH-në dhe taksat e shitjes në katër komunat në veri.

Ekziston një mospërputhje e prioriteve poashtu – përderisa serbët dëshirojnë së pari krijimin e Asociacionit, shqiptarët duan që së pari të bëhet shpërbërja e institucioneve paralele dhe implementimi i marrëveshjes së drejtësisë, dhe vetëm pastaj krijimi i Asociacionit/Komunitetit. Si kompromis, disa kanë propozuar që implementimi i këtyrë marrëveshjeve të bëhet në mënyrë paralele. Pjesëmarrësit janë pajtuar që mbajtja e zgjedhjeve të Kosovës në veri ka qenë e suksesshme, por se nuk është e mjaftueshme nëse komunat nuk janë funksionale dhe nëse pjesa tjetër e Marrëveshjes nuk implementohet. Disa kanë thënë se mosimplementimi është arsyeja kryesore pse BE-ja nuk i ka hapur negociatat me Serbinë në janar të vitit 2015.

MC-ja mbetet çështje diskutabile. Qeveria e Kosovës ka përgatitur një udhërrëfyes për punësimin e anëtarëve të saj në një numër institucionesh. Megjithatë, ekziston një mosmarrëveshje rreth numrave. Beogradi thotë se kjo forcë ka 751 anëtarë, kurse Prishtina ka ofruar 550 vende pune, ku 400 do të punësoheshin në një sërë institucionesh, 100 do të punësoheshin brenda tri viteve, por do të paguheshin në ndërkohë nga një fond kontigjent, kurse 100 do të punësoheshin përmes projekteve të financuara nga Fondi Zhvillimor për Veriun, i cili

deri më tani ka një buxhet prej 5 milion eurosh. Zyrtarët e Kosovës poashtu thonë se 88 do të pensionohen, kurse 150 anëtarë të MC-se nuk janë shtetas të Kosovës.*

Disa nga folësit shqiptarë kanë thënë se marrëveshjet janë të dëmshme për Kosovë dhe së këndejmi ato nuk duhet të impementohen dhe se dialogu duhet të ndalet. Një folës ka thënë se dialogu po shfrytëzohet thjesht si mjet për fuqizimin e qeverisë dhe dobësimin e opozitës. Një tjetër folës ka dhënë një shembull për të ilustruar se pse ata besojnë se Serbia përfiton më shumë se Kosova nga dialogu. Ai ka thënë se për të vozitur deri në Serbi, ai duhet të paguajë 130 euro, ti heq tabelat e regjistrimit të veturës, dhe të marrë targa të përkohshme me flamurin e Serbisë në to. Në anën tjetër, serbët paguajnë vetëm 20 euro për të hyrë në Kosovë, dhe atyre nuk u duhet t'i ndërrojnë targat e veturës, dhe mund të shfrytëzojnë letërnjoftimet e tyre. Një numër i folësve shqiptarë kanë thënë se Prishtina duhet të bëhet më e rreptë, përfshirë edhe masat reciproke.

Ka ekzistuar konsensus i gjërë se Asociacioni do të mund të luante një rol integrues nëse politikanët nuk do të ishin aq të përfshirë në krijimin, dhe më pas në menaxhimin e tij. Folësit shqiptarë kanë thënë se Asociacioni duhet të krijohet dhe të menaxhohet nga serbët e Kosovës, e jo nga Beogradi. Megjithatë, folësit serbë kanë thënë se Beogradi, jo vetëm që duhet të përfshihet në krijimin e Asociacionit, por duhet edhe ta financojë atë. Një numër pjesëmarrësish kanë thënë se as Beogradi e as Prishtina nuk brengosen shumë për Asociacionin apo për serbët në Kosovë; ata thjesht i përdorin ato për të fituar “pikë patriotike”.

Si të shpërbëhen njësitet e Mbrojtjes Civile dhe të formohet Asociacioni/Komuniteti?

Pjesëmarrës në punëtorinë e Stambollit kanë qenë analistë, këshilltarë qeveritarë, dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga Kosova dhe Serbia. Pjesëmarrësit kanë adresuar në veçanti mënyrat se si të shpërbëhet MC-ja dhe si të formohet Asociacioni. Ka pasur një konsensus në mesin e pjesëmarrësve se MC-ja duhet të shpërbëhet dhe anëtarët e saj duhet të integrohen në institucionet adekuate të Kosovës. Pjesëmarrësit kanë pasur qëndrime të ndryshme në lidhje me mandatin e Asociacionit.

Shpërbërja e Mbrojtjes Civile

Marrëveshja e Brukselit thotë se anëtarët e strukturave paralele të sigurisë në veri duhet të integrohen në institucionet e barasvlefshme të Kosovës. Forca paralele policore tashmë është integruar në Policinë e Kosovës. Për ndryshim nga anëtarët e policisë, anëtarëve të MC-së u janë ofruar pozita në rreth 15 institucione civile të Kosovës. Përfaqësuesit e Kosovës kanë thënë se Beogradi pretendon që MC-ja ka mbi 751 anëtarë. Prishtina ka ofruar vende pune për rreth 550 anëtarë. Pazari rreth numrave do të vazhdojë. Anëtarët e mbetur duhet të akomodohen përmes alokimit të fondeve tjera. Pjesëmarrësit janë pajtuar rreth pikave në vazhdim:

- Të punësohen anëtarët e MC-së në institucionet e Kosovës. Beogradi duhet ta dorëzojë listën më të fundit të anëtarëve të MC-së në veri dhe ofrojë dëshmi se kësaj liste nuk u janë shtuar anëtarë të rinj në momentin e fundit.

* Që nga koha e mbajtjes së kësaj tryeze, Prishtina dhe Beogradi kanë arritur marrëveshjen e cila parasheh punësimin e 483 anëtarëve të MC-së.

- Prapavija profesionale e anëtarëve të MC-së duhet të jetë në pajtim me vendet e reja të punës që u ofrohen atyre. Kur është e nevojshme, anëtarëve duhet t'u ofrohen trajnime.
- Të punësohen anëtarët e mbetur përmes alokimit të fondeve tjera. Fondi Zhvillimor për Veriun do të mund të përdoret për krijimin e vendeve të punës për disa nga anëtarët të cilët nuk mund të integrohen në institucionet e Kosovës. Beogradi paoshtu do të mund të ofrojë fonde për Fondin Zhvillimor apo për burime tjera, por nuk duhet të insistojë t'i paguaj pagat drejtpërdrejt.
- Beogradi duhet ta heqë nga legjislacioni i tij MC-në në Kosovë. MC-ja për momentin është institucion brenda Ministrisë së Mbrojtjes së Serbisë. Megjithatë, integrimi i MC-së duhet të ndodhë edhe nëse Beogradi refuzon ta ndryshojë ligjin e tij.
- Prishtina dhe Beogradi nuk duhet të shfrytëzojnë ekzistencën e MC-së si justifikim për ta vonuar implementimin e pikave tjera të Marrëveshjes.

Krijimi i Asociacionit/Komunitetit

Gjashtë nga pesëmbëdhjetë pikat e marrëveshjes së prillit 2013 mes Beogradit e Prishtinës u dedikohen Asociacionit. Prishtina dhe Beogradi kanë dhënë interpretime të ndryshme, e shpesh edhe kundërthënëse të këtyre pikave, kurse komuniteti ndërkombëtar deri më tash nuk ka qenë i gatshëm të japë çfarëdo sqarimi në lidhje me marrëveshjen. Megjithatë, paqartësitë vazhdojnë: Fjala “*vështrim*” (*overview*), është më e paqarta. Frazja “Asociacioni do të ketë vështrim (*overview*) mbi” nuk është e qartë as edhe në gjuhën angleze. Vështrimi mund të “jepet” ose të “ofrohet”, por nuk mund të “kiet vështrim”. E njëjta vlen edhe për përkthimin në gjuhën shqipe të fjalës “*overview*” *vështrim*. Nuk mund të “kiet vështrim”; mund të ofrohet vështrim. Përkthimi në gjuhën serbe “*nadležnost*” (kompetencë) është më afër interpretimit serb të mandatit të Asociacionit, por edhe ky nuk është përkthim korrekt i fjalës “*overview*”. Në këtë rast, “*pregled*” është përkthim më i saktë. Siç shihet nga pikat në vijim, pjesëmarrësit kanë pasur qëndrime mjaft të kundërta rreth mandatit të Asociacionit:

- Folësit shqiptarë kanë refuzuar fuqimisht çfarëdo fuqie ekzekutive për Asociacionin/Komunitetin. Ata kanë thënë se gjashtë pikat e marrëveshjes së Brukselit janë baza e mandatit të Asociacionit/Komunitetit. Në anën tjetër, pjesëmarrësit serbë kanë thënë se Asociacioni duhet të ketë fuqi thelbësore ekzekutive, duke përfshirë edhe buxhetin dhe stafin e tij.
- Pjesëmarrësit serbë kanë thënë se përgjegjësitë e Asociacionit duhet paoshtu të përfshijnë privatizimin e kompanive publike në komunat me shumicë serbe. Folësit shqiptarë kanë thënë se gjashtë pikat e marrëveshjes së Brukselit që kanë të bëjnë me Asociacionin/Komunitetin nuk duhet të rinegociohen, kështu që Asociacioni/Komuniteti mund të ketë rol monitories në fushat për të cilat ekziston pajtimi paraprak.
- Folësit shqiptarë kanë thënë se Beogradi do të mund të ofronte përkrahje financiare për Asociacionin përmes Fondit Zhvillimor për Veriun, apo përmes ndonjë burimi tjetër, por Beogradi nuk mund t'i paguajë pagat e të punësuarve të Asociacionit/Komunitetit. Ata kanë thënë se Asociacioni/Komuniteti do të jetë institucion i Kosovës dhe stafi i tij do të konsiderohen të punësuar publik të Kosovës, të cilët, sipas ligjeve të Kosovës, nuk mund të pranojnë paga nga një shtet tjetër. Folësit serbë kanë qenë hapur kundër asaj që Prishtina të ketë kontrollë financiare mbi Asociacionin/Komunitetin.

- Arsimi dhe shëndetësia mbesin çështje diskutabile. Kryetarët e komunave në veri dhe Beogradi dëshirojnë që arsimi dhe shëndetësia të menaxhohen nga Asociacioni/Komuniteti. Qeveria e Kosovës thotë se këto fusha janë kompetenca të menaxhmentit komunal. Si rezultat i kësaj, pjesëmarrësit shqiptarë kanë propozuar që komunat duhet t'i pranojnë buxhetet e ofruara nga Prishtina, por mos t'i përdorin mjetet e dedikuara për arsim dhe shëndetësi derisa të jetë formuar Asociacioni/Komuniteti. Megjithatë, folësit serbë nuk janë pajtuar. Ata kanë thënë se këto fonde nuk duhet të përfshihen fare në buxhet para se të formohet Asociacioni/Komuniteti.

INTEGRIMI I VERIUT TË KOSOVËS DHE PJESËMARRJA POLITIKE E SERBËVE

Krijimi i institucioneve lokale

Qeveria e Kosovës dhe përfaqësuesit e katër komunave me shumicë serbe në veri kanë qenë të përfshirë në një betejë komplekse rreth krijimit të institucioneve komunale. Prishtina insiston se komunat duhet të krijohen në bazë të ligjeve të Kosovës, kurse përfaqësuesit serbë kërkojnë që veriu të mbetet autonom, dhe që institucionet komunale të jenë neutrale ndaj statusit. Me qëllim të adresimit të këtyre pozicioneve kontradiktore, në maj të vitit 2014, CIG ka organizuar në Prishtinë një tryezë të rrumbullakët për një numër përfaqësuesish të partive politike të Kosovës, zyrtarëve të komunave me shumicë serbe, dhe anëtarëve të shoqërisë civile.

Përfaqësuesit e katër komunave në veri thonë se Marrëveshja e Brukselit parasheh që institucionet në veri të jenë neutrale ndaj statusit. Ata pranojnë i zbatojnë ligjet e Kosovës – që është dëshmuar me pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet e Kosovës – por pa iu referuar atyre dhe duke përdorur simbole serbe, përfshirë edhe vulat e komunës. Përfaqësuesit qeveritarë të Kosovës besojnë se Marrëveshja e Brukselit është e qartë sa i përket ligjeve të cilat duhet aplikuar. Zgjedhjet janë mbajtur në bazë të ligjeve të Kosovës dhe së këndejmi, edhe komunat duhet të krijohen në bazë të ligjeve të Kosovës. Ata thonë se është vullneti politik ai që mungon, e jo qartësia e Marrëveshjes. Ata poashtu fajësojnë zyrtarët e Beogradit për inkurajimin e serbëve në veri për ti rezistuar krijimit të komunave.

Disa nga përfaqësuesit nga veriu kanë thënë se kanë nevojë për më shumë kohë për të këtë tranzicion, pa e definuar strukturën e këtij tranzicioni. Por arsyesja e dhënë për nevojën e një periudhe tranzitore më të gjatë ka qenë, para së gjithash, rezistenca e fuqishme e popullatës ndaj integritetit. Njëri nga folësit ka thënë se kjo rezistencë duhet të adresohen pa presion dhe pa afate kohore. Ai ka propozuar që vendet e reja të punës duhet të krijohen dhe disa projekte zhvillimore duhet të implementohen, në mënyrë që popullata si shohë të mirat e integritetit. Megjithatë, një tjetër folës ka thënë se ky “tranzicion i mendjes dhe zemrës” do të marrë shumë më shumë kohë dhe se ai nuk duhet të lidhet me proceset teknike, siç janë statutet komunale. “Statutet duhet të krijohen tani, ne nuk mund të presim derisa njerëzit të ndërrojnë mendje”. Ai ka shtuar se “ne nuk mund të kërkojmë më shumë kohë kur edhe ashtu kemi ngelur prapa në afatet kohore të parapara në Marrëveshje”.

Një folës ka thënë se kryetarët e komunave me shumicë serbe në jug duhet ti inkurajojnë kryetarët e komunave në veri për krijimin e institucioneve të tyre. Kryetarët e komunave në veri duhet të ulen së bashku me serbët nga jugu dhe të shohin se si është arritur integrimi atje. Ky folës ka thënë se veriu duhet t'i shfrytëzojë mundësitë dhe vëmendjen që e gëzojnë nga Prishtina, komunitetit ndërkombëtar dhe Beogradi. Ajo ka shtuar se nga përvoja e saj personale në jug, kjo vëmendje zhduket shpejtë dhe “më nuk mund ta kthesh asnjëherë”.

Ekzistojnë edhe storie suksesi. Zyrtarët policorë serbë janë integruar me sukses në forcën policore të Kosovës. Shumë njerëz kanë menduar se kjo ka qenë njëra nga çështjet më të ndjeshme që do të zgjidhej e fundit. Policët serbë ka qenë mbrojtësit më të fuqishëm të sistemit të Serbisë, por ata tanimë mbajnë simbolet e Kosovës, dhe deri më tani nuk është shënuar asnjë incident.

Edhe pse çështja e statuteve të komunave dhe simboleve kanë mbushur pjesën më të madhe të diskutimeve në muajt e fundit, pjesëmarrësit kanë thënë se ekziston një numër i sfidave dhe më të komplikuar: ofrimi i shërbimeve për popullatën, përfshirë lëshimin e dokumenteve të Kosovës; krijimi i Asociacionit/Komunitetit; dhe lëshimi i targave të automjeteve. Pjesëmarrësit kanë përmblyllur takimin me pikat në vazhdim:

- *Përvoja në komunat jugore mund t'u shërbejë komunave në veri.* Edhe pse përfaqësuesit serbë në komunat me shumicë serbe në jug nuk e njohin shtetin e Kosovë, dhe nuk kanë simbole të shtetit të Kosovës në zyret e tyre, ata megjithatë kanë gjetur disa modele të pranueshme për krijimin dhe operacionalizimin e institucioneve. Kjo përfshinë edhe lëshimin e dokumenteve, mbledhjen e taksave, dhe implementimin e projekteve zhvillimore. Përfaqësuesit serbë nga jugu kanë thënë se as atyre nuk u kanë pëlqyer zgjedhjet të cilat kanë shpër kah integrimi, por një gjë e tillë ua ka mundësuar organizimin e jetës në mënyrë institucionale.
- *Beogradi duhet të përfshihet në qartësimin e Marrëveshjes së Brukselit.* Beogradi ka qëndruar anash gjatë mosmarrëveshjeve të vazhdueshme rreth statuteve komunale dhe simboleve mes Prishtinës dhe serbëve në veri. Një numër i përfaqësuesve të Kosovës dhe zyrtarëve ndërkombëtarë besojnë se Beogradi është prapa rezistencës së serbëve. Beogradi duhet t'ua qartësojë serbëve në veri marrëveshjen që është arritur në Bruksel.
- *Komunat duhet të ofrojnë shërbime.* Më shumë se gjashtë muaj kanë kaluar nga zgjedhjet e fundit, dhe komunat nuk janë formuar ende, kryesisht për shkak të mosmarrëveshjeve rreth statuteve dhe simboleve. Votuesve ende nuk u ofrohen shërbime nga institucionet për të cilat kanë votuar. Shumica presin që lëshimi i dokumenteve të Kosovës do të jetë një nga çështjet më kontradiktore.

Angazhimi i serbëve në politikën e Kosovës

Në qershor të vitit 2014, CIG ka organizuar një tryezë të rrumbullakët në Beograd për përfaqësuesit e partive të serbëve të Kosovës, partive të Serbisë, zyrtarëve qeveritarë të Serbisë, dhe një numër analistësh serbë, me qëllim të adresimit të rolit të serbëve të Kosovës të sapozgjedhur në institucionet qendrore të Kosovës. Serbët e Kosovës në veri kanë marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare të Kosovës për herë të parë qysh kur Kosova shpalli pavarësinë në vitin 2008. Në kuadër të kornizës së tanishme ligjore, serbët e Kosovës i kanë të garantuara 10 ulëse

në parlament, dhe kanë të drejtë të udhëheqin me dy ministri, nëse qeveria e Kosovës ka më shumë se 12 sosh. Qeveria e kaluar ka punuar me 19 ministri. Nëse numri i ministrive është më i ulët se 12, atëherë serbët e Kosovës kanë të drejtë ta kenë një post ministror. Lista Srpska ka fituar nëntë nga 10 ulëset e garantuara në zgjedhjet e qershorit, dhe këtu përfshihen edhe disa anëtarë të Partisë së Pavarur Liberale, e cila ka qenë pjesë e qeverisë me tri ministri në mandatin e kaluar.

Lista Srpska ka përkrahjen e qeverisë së Serbisë dhe pritet që të veprojë në koordinim të afërt me Beogradin. Disa e shohin këtë përkrahje si një kontribuues në përmirësimin e interesave të serbëve të Kosovës. Megjithatë, një numër folësish kanë thënë se frikësohen se Beogradi para së gjithash do t'i inkurajojë deputetët e rinjë që të ndjekin interesat e shtetit të Serbisë për të "minuar dhe refuzuar institucionet e Kosovës", dhe vetëm pasi ta ketë bërë këtë, të merret me çështjet që i brengosin serbët e Kosovës. Për më shumë, ata janë të shqetësuar se "përplasjet e vazhdueshme në institucione do ta ngrisin nivelin e përgjithshëm të tensioneve mes serbëve e shqiptarëve, duke i lënë në hije çështjet reale, dhe duke i bërë serbët të duken si ngatërrestarë". Partitë e shqiptarëve të Kosovës e shohin Listën Srpska më një dozë dyshimi dhe shumë prej tyre e quajnë atë "Kali i Trojës". Në këtë kuptim, shumica e folësve kanë thënë se "beteja" mbi çështjet nacionale duhet të luftohet nga Beogradi, kurse përfaqësuesit politik të serbëve të Kosovës do të duhej të merreshin ekskluzivisht me çështjet e komunitetit serb në Kosovë.

Qëllimi i deklaruar i Beogradit gjithmonë ka qenë fuqizimi i komunitetit serb në Kosovë, dhe sipas një folësi, dialogu i Brukselit ka qenë kryesisht për interesat e serbëve të Kosovës. Një folës i njohur me politikën e Beogradit në raport me Kosovës ka thënë se Beogradi do të vazhdojë të dialogojë me Prishtinën rreth çështjeve të telekomunikimit, energjisë, si dhe gjyqësorit në veri, me qëllimin kryesor që ta përmirësojë jetën e serbëve të Kosovës. Ai ka konfirmuar se Beogradi nuk do ta zvogëlojë përkrahjen politike e financiare për serbët e Kosovës. Në lidhje me incidentet e fundit që pasuan ndërtimin e parkut në urën e Mitrovicës, një folës e ka fajësuar Prishtinën dhe komunitetin ndërkombëtar për ekzagjerimin e çështjes. "Nuk është e kuptueshme pse Uashingtoni dhe Brukseli janë duke folur për parkun, sikur ky të ishte problemi kryesor në Kosovë". Ai ka thënë se Lista Srpska do të veprojë si një trup i bashkuar në institucionet e Kosovës, dhe do të vendosë një numër objektivash të cilat dëshiron ti arrijë gjatë mandatit të saj. Ai poashtu ka thënë se Lista Srpska do të ketë një pozicion më të rreptë se sa grupet e kaluara serbe në institucionet e Kosovës.

Menaxhimi i Beogradit i Listës Srpska, nga një numër i folësve të serbëve të Kosovës është konsideruar si një hap prapa në procesin e demokratizimit përbrenda komunitetit serb në Kosovë. Serbët e Kosovës në të kaluarën kanë formuar në mënyrë të pavarur një numër të partive politike, kanë zhvilluar kapacitetet për fushata demokratike, kanë konkurruar në procesin zgjedhor dhe, edhe pse në lista të ndara, ia kanë dalë të vendosin një bashkëpunim efikas në parlament. Një folës ka thënë se pas gjithë këtij përparimi, brenda vetëm disa javësh, Lista Srpska e ka minuar gjithë progresin e viteve të kaluara.

Kryetari i komunës është ankuar se Lista Srpska është një zgjatim i Lëvizjes së Socialistëve, një parti e vogël e Serbisë e udhëhequr nga ministri i Serbisë Aleksandar Vulin, duke qenë se pesë nga nëntë anëtarët e parlamentit nga Lista Srpska janë anëtarë të kësaj partie politike. Sa i përket votimit në veri të Kosovës, disa folës kanë thënë se ka qenë një mashtrim total. "Votuesit kanë

votuar për ata për të cilët Beogradi ka vendosur ti zgjedhë. Në fakt këta njerëz nuk janë zgjedhur; ata janë caktuar”. Ky folës ka shtuar se votimi i refugjatëve në Serbi ka qenë “katastrofal”. “Një person ka mbushur mbi 10 mijë fletëvotime me lapsin e njejtë, duke u dhënë votën vetëm pesë njerëzve, të gjithë të partisë së Vulinit”.

Disa folës kanë thënë se një listë e përbashkët mund të jetë e dëshirueshme në kontekstin e tanishëm, por kanë pasur ankesa rreth qasjes së Beogradit për të “mikromenaxhuar” çdo aspekt të fushatës, përfshirë edhe përpilimin e listës së kandidatëve, pa konsideruar asnjë “kriter demokratik”. “Është mirë ta kemi një listë të përbashkët në këto rrethana, por poashtu duhet ti definojmë qëllimet të cilat na bashkojnë dhe nëse njerëzit në këtë listë mund të kontribuojnë në këto qëllime. Një listë etnike nuk është e mjaftueshme për përmirësimin e jetës së komunitetit serb. Në këtë drejtim nevojiten profesionistët”, ka thënë një folës. Ai ka shtuar se nuk ka garanci se 10 anëtarët e zgjedhur të parlamentit nga serbët e Kosovës do t’i ndjekin qëllimet e përbashkëta dhe se do të jenë të aftë të arrijnë shumë, duke qenë se shumica prej tyre kanë mungesë të përvojës në politikë në përgjithësi, dhe në punën më institucionet e Kosovës, në veçanti”. Për më shumë, këtë grup njerëzish nuk e bashkon asgjë tjetër përveç përkatësisë etnike. Ata nuk kanë qëllime të përbashkëta apo një strategji për ti arritur ato. Si e tillë, Lista Srpska nuk e përfaqëson forcën autentike të serbëve të Kosovës, qëllim ky i shume serbëve të Kosovës gjatë gjithë këtyre viteve.

Një numër i folësve serbë të Kosovës u kanë rekomanduar zyrtarëve në Beograd që të mos e përdorin këtë grup njerëzish për interesat e ngushta të tyre. “Mos i shtyeni të luftojnë me shqiptarët e Kosovës; inkurajoni ata të vendosin bashkëpunimin dhe të veprojnë si një forcë për zgjidhjen e shumë problemeve të mbledhura gjatë viteve”. Folësit kanë thënë se bashkëpunimi është opcioni më i mirë, duke qenë se shqiptarët e Kosovës kanë shumicën absolute dhe se përveç ndryshimit të kushtetutës, ata mund të aprovojnë dhe implementojnë çfarëdo ligji pa serbët e Kosovës. Deputetët serbë të Kosovës, dhe ata të cilët janë duke udhëhequr dy ministritë, do të duhej të insistonin në implementimin e plotë të ligjeve të pakos së Ahtisaarit që kanë të bëjnë me komunitetin serb në Kosovë. Një folës ka raportuar se shqiptarët e Kosovës nuk kanë qenë të gatshëm ti implementojnë këto ligje dhe “janë të lumtur kur serbët e Kosovës e refuzojnë planin”. Edhe kur interesat e serbëve të Kosovës përkthehen në akte ligjore, ato shumë rrallë implementohen në tërësi. Kjo ndodhë pjesërisht për shkak të angazhimit të pamjaftueshëm politik të serbëve të Kosovës.

Beogradi nuk duhet të ndërmarrë veprime të cilat tërheqin vëmendje, por nuk i zgjidhin problemet me të cilat ballafaqohen serbët. Sipas disa folësve, në fakt, ato vetëm vënë nën hije çështjet kryesore. Një veprim i tillë ka qenë ndërtimi i parkut në urën në Mitrovicë. “Parku është një lojë fëmijësh. Parqet në urë nuk kanë kurrfarë kuptimi dhe nuk ekzistojnë askund në botë. Askush nuk përfiton nga kjo lojë, as edhe vetë krijuesit e kësaj lojë”, ka thënë një folës.

Një tjetër folës ka thënë se porosia e Beogradit është kundërthënëse: ajo kërkon nga serbët e Kosovës të marrin pjesë në zgjedhjet e Kosovës me simbole të Kosovës, por tani kërkon nga serbët e Kosovës të zgjedhur me vota, të refuzojnë krijimin e komunave për shkak të simboleve të Kosovës. “Ne jemi të hutuar; nuk dijmë çfarë të presim nga Beogradi. Beogradi nuk ka pasur një politikë konsekuente për një kohë shume të gjatë”. Një folës ka thënë se politikanët vazhdimisht janë duke krijuar geto, në vend se ta përmirësojnë integrimin.

Integrimi i veriut dhe normalizimi i marrëdhënieve

Në qershor të vitit 2014, CIG ka organizuar në Stamboll një tryezë të rrumbullakët për përfaqësuesit e partive politike dhe shoqërisë civile nga Kosova dhe Serbia. Diskutimi ka adresuar çështjen e krijimit të institucioneve lokale në veri të Kosovës, si dhe normalizimin e marrëdhënieve mes Prishtinës e Beogradit. Implementimi i marrëveshjeve, sipas një analisti, është duke u vonuar për shkak se askush nuk është në nguti. Për më shumë, transferimi i fuqisë nga një palë institucione në institucionet tjera është proces i ndërlikuar, edhe atëherë kur bëhet mes institucioneve të cilat janë miqësore ndaj njëra tjetrës.

Pjesëmarrësit kanë raportuar një numër pengesash politike dhe teknike. Pengesat teknike janë të ngjajshme me ato me të cilat janë ballafaquar komunat tjera me shumicë serbe në jug të Kosovës gjatë formimit të tyre, por problemet politike janë më të ndërlikuara. Kjo rrjedh nga fakti se formimi i komunave në veri bazohet në një marrëveshje të shtyrë nga interesat nacionale të Serbisë dhe Kosovës, e jo nga nevoja për zgjidhjen e mosmarrëveshjes rreth veriut dhe normalizimit të gjendjes në terren.

Një folës ka thënë se marrëveshja e Brukselit ka qenë rezultat i ambicieve të Serbisë për të bërë përparim drejt BE-së, dhe dinamika me të cilën do të ecë implementimi do të varet nga shpejtësia me të cilën Serbia do të bëjë përparim drejt anëtarësimit. “Beogradi do të ndërmarrë hapa pozitivë kur të jetë afër që të marrë diçka, si p.sh. statusin e kandidatit apo datën për fillimin e negociatave nga Brukseli”. Një tjetër folës ka theksuar se kryetarët e komunave në veri nuk janë problemi, duke shtuar se “kryetarët e komunave janë duke bërë cdo gjë që kërkohet nga ta; ata nuk janë në pozitë ta kundërshtojnë Beogradin, edhe nëse do të dëshironin ta bënë në gjë të tillë”. Ai ka konkluduar duke thënë se burimi, dhe në të njëjtën kohë zgjidhja e problemit është në Beograd, dhe se komuniteti ndërkombëtar do të duhej ta shtonte trysninë ndaj Beogradit në mënyrë që të rrespektohen afatet për implementimin e Marrëveshjes së Brukselit.

Një folës i afërt me aspektet teknike të krijimit të komunave ka treguar për rezultate të dobëta rreth implementimit. Ai ka thënë se komunat e veriut përdorin vetëm rreth 7 për qind të buxhetit të tyre, që shënon një rritje prej 2 për qind që ka ekzistuar në muajin e kaluar. Pengesat për marrjen e buxheteve, siç janë statutet dhe simbolet janë eliminuar, por kryetarët e komunave duket sikur nuk janë të gatshëm të pranojnë fonde nga institucionet e Kosovës. Ai ka treguar se kryetarët e komunave janë duke ndërmarrë hapa shumë të vegjël dhe të kujdesshëm drejt integritit. “Hapa aq të vegjël sa të mos shihen si pranim i institucioneve të Kosovës, dhe aq të mëdhenj sa mos ta çënojnë haptazi ligjin që do të rezultonte në zgjedhje tjera lokale”.

Por edhe hapat e vegjël janë joekzistent. “Komunat e Kosovës nuk funksionojnë aspak, dhe të gjithë e dijmë këtë, dhe asnjë shërbim i vetëm lokal nuk ofrohet nga to”. Megjithatë, është raportuar se shërbimet vazhdojnë të ofrohen nga institucionet e Serbisë. Ky folës ka shtuar se zgjedhjet parlamentare nuk kanë qenë të rregullta, dhe se ato “kanë qenë të manipuluar nga zyrtarët serbë”. Ai ka shtuar se kryetarët e komunave të veriut dhe zyrtarët tjerë të zgjedhur, nuk brengosen për qytetarët e tyre, për faktin e thjeshtë se ata nuk janë elektorati i tyre. Këta zyrtarë janë zgjedhur nga Serbia dhe ata e shohin qeverinë e Serbisë si votuesin e tyre primar, duke u pergjigjur kështu vetëm në urdhërat që vijnë nga Beogradi. Ai ka thënë se komuniteti ndërkombëtar duhet të jetë më i rreptë me Beogradin dhe zyrtarët lokalë në veri. Ai ka treguar se

as asambltetë komunale nuk janë duke funksionuar. “Asambltetë lokale nuk mbajnë mbledhje”. Nuk ka komunikim mes kryetarëve të komunave dhe qytetarëve. Qytetarët nuk e dijnë se për çfarë janë përgjegjës kryetarët e komunave.

Një numër i folësve kanë thënë se arsyeja prapa rezultateve të dobëta në veri është mungesa e qartësisë së marrëveshjes së Brukselit. Por një folës tjetër ka thënë se marrëveshja e Brukselit është “shumë e qartë; është e paqartë vetëm për ata të cilëve kjo marrëveshje nuk iu pëlqen”. Ai ka shtuar se arsyeja pse komunat nuk janë duke funksionuar është për shkak se ata të cilët janë përgjegjës, nuk janë të interesuar që ato të funksionojnë, dhe jo pse nuk e kanë të qartë se si ti formojnë ato. “Ne po vazhdojmë ta gënjejmë njëri tjetrin, të nënshkruajmë marrëveshje, dhe një vit më vonë nuk i kemi as elementet më bazike, siç janë statutet e komunave”, ka thënë një folës. Ai e ka fajësuar Beogradin për mungesën e përparimit në veri, por edhe Prishtinën për mosgatishmërinë e saj për të implementuar shumë gjëra që janë në planin e Ahtisaarit. Ai ka theksuar se bazuar në përvojën e tij në jug, krijimi i komunave është çështje politike, e jo teknike. “Çështjet teknike mund të zgjidhen brenda ditës”. Ai ka propozuar që serbët ta përgatisin statutin për Asociacionin e Komunave, mandatin e tij, t’i qartësojnë përgjegjësitë, dhe t’i identifikojnë burimet e financimit. Ai ka shtuar se Prishtina do të duhej gjithashtu t’u jepte më shumë përgjegjësi dhe fonde komunave veriore, porse edhe kryetarët e komunave në veri duhet ta dijnë dhe ta pranojnë faktin se ata janë kryetarë të komunave të Kosovës.

Pjesëmarrësit kanë konkluduar se kryetarët e komunave në veri duhet t’i nominojnë drejtorët e tyre komunal, ti kompletojnë detyrat e mbetura administrative në mënyrë që t’i marrin buxhetet e tyre, t’i krijojnë administratat komunale, t’i zgjidhin çështjet ende të hapura rreth simboleve, ta hartojnë së bashku një strategji të zhvillimit, si dhe të fillojnë implementimin e projekteve.

Rekomandimet e politikave për përfaqësuesit e serbëve të Kosovës

Në shtator të vitit 2014, CIG ka organizuar një punëtori në Aranzhelovac dhe një tryezë të rrumbullakët në Beograd për një numër përfaqësuesish serbë. Pjesëmarrësit e tryezës kanë rishikuar, diskutuar dhe kontribuar në rekomandimet e përpiluara në Aranzhelovac, dhe janë pajtuar ti përkrahin ato.

1. Rol aktiv në formimin e qeverisë

- a. Definimi i qëllimeve strategjike për t’iu bashkuar koalicionit qeverisës.
- b. Përfaqësimi transparent i interesave të komunitetit serb në Kosovë gjatë negociatave për formimin e qeverisë.
- c. Përfaqësuesit serbë në parlamentin e Kosovës, përveç temave të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura me komunitetin serb, duhet poashtu të merren me çështje tjera të rëndësishme publike.

2. Zgjedhja e përfaqësuesve serbë të komunitetit serb në të gjitha nivelet e qeverisë është thelbësore.

- a. Përfaqësuesit me përvojë politike, autoritet, reputacion dhe kredibilitet duhet të nominohen dhe të zgjedhen si anëtarë të qeverisë.
- b. Duhet të punësohen më shumë ekspertë në nivelin qendror dhe lokal, për të përkrahur punën e përfaqësuesve serbë. Kurdo që është e mundur, duhet të punësohen serbët e Kosovës për këto pozita.

- c. Të promovohen principet e barazisë gjinore dhe përfaqësimit rajonal në zgjedhjen e përfaqësuesve.
- d. Ndërtimi i marrëdhënieve më të mira me shumicën dhe komunitetet tjera, me qëllim të stabilizimit të gjendjes dhe përmirësimit të bashkëjetesës në Kosovë.

3. *Vazhdimi i dialogut të Brukselit*

- a. Përfaqësuesit serbë në parlament, qeveri dhe në institucionet tjera në Kosovë, duhet që në mënyrë aktive të promovojnë procesin e pajtimit dhe bashkëjetesës, si dhe të përdorin ndikimin e tyre në definimin e temave në dialogun e Brukselit.
- b. Zgjidhja e problemeve në sistemin e edukimit dhe shëndetësisë është prioritet (p.sh. njohja e diplomave të Universitetit të Mitrovicës)
- c. Sigurimi i plotë i lirisë së lëvizjes (targat, pagesa e sigurimit në pikëkalimet administrative, dokumentet personale etj.)

4. *Zhvillimi ekonomik*

- a. Pjesëmarrje e plotë e përfaqësuesve të autoriteteve lokale në procesin e privatizimit, dhe angazhimi i përfaqësuesve të komunitetit serb në parlament në inicimin e diskutimeve me qëllim të shqyrtimit të procesit.
- b. Krijimi dhe fuqizimi i infrastrukturës së biznesit me qëllim të ngritjes së nivelit të konkurrueshmërisë.
- c. Ulja e tatimeve dhe ngarkesave të cilat dobësojnë konkurrueshmërinë, si dhe garantimi i zbatimit më efikas të marrëveshjes së CEFTA-s.
- d. Largimi i pengesave tregtare, siç janë monopolet dhe kartelet që kanë monopolizuar importet.
- e. Mundësimi i reregjistrimit të entiteve biznesore që janë të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Republikën e Serbisë në Regjistrin Komercial të Kosovës, përmes një procedure të lehtësuar.

Angazhimi i serbëve në institucionet qendrore

Perceptimi se pjesëmarrja e serbëve në institucionet e Kosovës është i barabartë me njohjen e pavarësisë së Kosovës kishte bërë që komuniteti serb të përmbahet nga votimi në zgjedhjet e Kosovës dhe që qeveria e Serbisë të mos e mbështesë atë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. E gjithë kjo ndryshoi pas marrëveshjes mes Prishtinës dhe Beogradit të arritur në Bruksel, më 19 prill të vitit 2013. Në pajtim me marrëveshjen dhe të inkurajuar nga Beogradi, serbët në veri të Kosovës votuan në masë më të madhe në zgjedhjet parlamentare të Kosovës të organizuara në qershor të vitit 2014, për herë të parë qysh nga shpallja e pavarësisë së Kosovës. Lista Srpska, e mbështetur nga Beogradi, fitoi 9 nga 10 ulëset parlamentare të rezervuara për serbët. Serbët kanë të drejtë për të mbajtur dy pozita ministrore në qeveri. Shumica presin një marrëdhënie të ndërlikuar mes partive shqiptare dhe Listës Srpska në koalicionin qeveritar, duke marrë parasysh së Srpska nuk e njej pavarësinë e Kosovës, dhe së këndejmi, as institucionet e saj. Shumica pyesin veten se çfarë roli do ta marrë Srpska: rol pragmatik apo refuzues.

Për të adresuar rolin e serbëve në institucionet e Kosovës, në shtator të vitit 2014, CIG ka organizuar në Prishtinë një tryezë të rrumbullakët për disa përfaqësues politik dhe përfaqësues të shoqërisë civile të Kosovës. Folësit kanë listuar një numër çështjesh të cilat kanë përfshirë edukimin, posaçërisht në legalizimin e Universitetit të Mitrovicës; shëndetësinë, me theks të veçantë në kornizën ligjore për klinikat serbe në Kosovë; privatizimin e kompanive në hapësirat

me shumicë serbe me qëllim të ofrimit të benefiteve për popullsinë lokale që dalin nga ky proces; dhe bujqësinë me qëllim të rritjes së kapaciteteve të prodhimit dhe garantimit të qasjes së serbëve në tregjet lokale të Kosovës.

Një numër i folësve kanë thënë se bashkëpunimi i serbëve me komunitetin shumicë është kyç për një performancë të suksesshme në institucione dhe për përmirësimin e jetës së serbëve të Kosovës. Shumë pjesëmarrës serbë kanë qenë të brengosur rreth përvojës së pamjaftueshme parlamentare të përfaqësuesve serbë. Për më shumë, ata poashtu kanë mungesë të legjitimitetit pasi që “ata kanë qenë të zgjedhur nga individët të cilët kanë mbushur kutitë e votimit në Beograd”, kanë thënë disa folës. Si pasojë e kësaj, shumë prej tyre kanë pritur që Beogradi të vazhdojë të negociojë me institucionet e Kosovës në emër të serbëve të Kosovës.

Institucionet e Kosovës duhet të fillojnë një dialog të vërtetë me serbët e Kosovës në çështje rreth zhvillimit ekonomik, bujqësisë, edukimit dhe punësimit, ka rekomanduar një folës nga një parti opozitare. Ai ka thënë se partitë opozitare shqiptare janë të vendosura të fillojnë një dialog thelbësor me serbët, por “serbët ende nuk janë të gatshëm ta bëjnë këtë në mënyrë vetanake, duke preferuar që Beogradi të negociojë në emër të tyre”. Disa folës kanë thënë se ekziston rreziku që përfaqësuesit e rinj të shihen si një dorë e zgjatur e Beogradit dhe rrjedhimisht, të mos merren seriozisht nga udhëheqësia shqiptare. Një numër folësish kanë fajësuar komunitetin ndërkombëtar për lejimin e vjedhjes së votave, gjë e cila ka bërë të mundshme zgjedhjen e një numri “kandidatësh të caktuar paraprakisht”. Disa kanë thënë se shumica e kandidatëve janë “nominuar, e nuk janë zgjedhur”.

Një numër folësish shqiptarë kanë thënë se legjitimiteti i përfaqësuesve serbë është një “çështje ndër-serbe”. Shqiptarët nuk do të duhej ta vënin në pikëpyetje legjitimitetin e përfaqësuesve serbë. “Kjo është ajo që kemi, dhe duhet të punojmë me atë që ekziston”. Fundi i fundit, një numër i madh i përfaqësuesve shqiptarë në zgjedhjet e fundit, kanë qenë rezultat i “vjedhjes industriale” të zgjedhjeve të vitit 2010. Ai ka shtuar se autenticiteti i udhëheqësisë është një mbivlerësim. Serbët kanë pasur përfaqësues autentik në të kaluarën, por megjithatë nuk kanë qenë në gjendje të bëjnë shumë. Ky folës ka theksuar se serbët në Kosovë kanë të drejtë të konsultohen me Beogradin, ashtu si edhe “shqiptarët kanë të drejtë të konsultohen me Tiranën”.

Dialogu i drejtpërdrejt mes Prishtinës dhe serbëve lokal mund të jetë më i vështirë se bisedimet e nivelit të lartë të lehtësuara nga BE-ja, sepse do të ishte origjinal, “jo një farsë sikurse procesi i Brukselit”, ka thënë një folës. Dialogu i Brukselit i ka dhënë hapësirë mjaft të madhe Beogradit, por ka anashkaluar serbët e Kosovës, të cilët ende nuk kanë zgjidhje as edhe për shërbimet më bazike, siç janë kujdesi shëndetësor dhe edukimi. Kompetencat shtesë për komunat në veri nuk do ta përmirësojnë jetën e serbëve atje; ajo që u nevojitet atyre janë komuna profesionale dhe kompetente. Ai ka shtuar se dialogu me serbët duhet të fokusohet në politika programore, e jo në ato etnike.

Edhe pse institucionet e reja të Kosovës nuk janë formuar edhe katër muaj pas zgjedhjeve, dhe përfaqësuesit e rinj serbë nuk e kanë pasur ende mundësinë të angazhohen në politika qendrore, shumica e folësve kanë thënë se ata duhet të vendosin një bashkëpunim të mirë me kolegët e tyre shqiptarë, dhe ka propozuar që ata sa më shpejtë të fillojnë të adresojnë çështjet e edukimit, shëndetësisë, dhe privatizimit në komunat me shumicë serbe. Asnjë nga këto çështje nuk mund të

zgjidhet pa bashkëpunimin thelbësor me Prishtinën. Shumë pjesëmarrës shqiptarë dhe serbë besojnë se pjesëmarrja e të gjithë serbëve të Kosovës në jetën politike të Kosovës – si pjesë e institucioneve dhe duke votuar në zgjidhje – do të ndihmojë në zgjidhjen e çështjeve në nivelin lokal.

BASHKËPUNIMI PARLAMENTAR

Përderisa është përgjegjësi e ekzekutivit që t'i negociojnë marrëveshjet, parlamentarët kanë një rol të rëndësishëm në mbikqyrjen, duke shtruar pyetje, si dhe në implementimin e marrëveshjeve përmes miratimit të ligjeve të nevojshme. Në këtë kontekst, bashkëpunimi mes parlamentarëve të Kosovës dhe Serbisë është me shumë vlerë, duke qenë se të dyja vendet pritet të miratojnë ligje të reja në mënyrë që të mundësohet implementimi i marrëveshjeve. Kjo jo vetëm që do të shënonte fillimin e një bashkëpunimi të ri institucional, por gjithashtu do të plotësonte përpjekjet e qeverive në Prishtinë e Beograd në procesin e normalizimit të marrëdhënieve dhe konsolidimit të të arriturve të deritashme.

Në dhjetor të vitit 2014, CIG ka organizuar në Prishtinë një tryezë të rrumbullakët për anëtarët e parlamentit të Kosovës dhe Serbisë. Për një numër deputetësh nga Beogradi, kjo ka qenë vizita e tyre e parë në Kosovë. Qëllimi i takimit ka qenë kontribuimi në normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë, dhe mes shoqërive shqiptare dhe serbe. Shumica e folësve kanë përkrahur vazhdimin e dialogut, dhe poashtu kanë propozuar që dialogu dhe bashkëpunimi duhet të zgjerohen edhe në fusha tjera, me qëllim të arritjes së normalizimit të marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës. Qëllimi i CIG është që bashkëpunimi institucional mes Prishtinës e Beogradit të transformohet nga të qenit ngjarje “historike” në ngjarje “të zakonshme”. Këto takime duhet të mbahen vetëm në Kosovë dhe Serbi, e jo në një vend të tretë.

Pjesëmarrës në këtë takim kanë qenë përfaqësues të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dhe Partisë Progresive Serbe (SNS), Partisë Socialiste të Serbisë (SPS), Partisë Demokratike (DS), Partisë Social-Demokrate (SDS), dhe Lidhjes së Social Demokratëve të Vojvodinës (LSV).*

Dialogu duhet të jetë më transparent dhe komunikimi mes qeverive dhe shoqërive duhet të ngritet. Dialogu duhet poashtu t'i përfshijë mediat, biznesin, sportin dhe fushat tjera në mënyrë që t'i përmirësojë marrëdhëniet mes shoqërive në të gjitha fushat. Në lidhje me rolin e parlamenteve në këtë dialog, folësit janë ankuar se ata janë anashkaluar në procesin e dialogut. Kryeministri i Kosovës ka raportuar disa herë në parlament, por disa kanë thënë se në këto raportime, nuk janë dhënë informata të detajuara. Në parlamentin serb nuk ka pasur as raportim formal. “Nuk mund të përkrahë diçka për të cilën nuk kam informata”, ka thënë një folës.

Folësit kanë thënë se ata duhet të jenë më aktiv në ofrimin e këshillave dhe ideve, në mbikqyrjen dhe monitorimin e qeverisë dhe implementimin e marrëveshjes, si dhe në kërkimin e më shumë informatave të detajuara mbi procesin e dialogut. Është përmendur idea që të dyja parlamentet të

* Në vitin 2015, deputetët e parlamentit të Serbisë nga rradhët e Partise për Veprim Demokratik dhe Lëvizjes Preokret u janë bashkuar diskutimeve.

krijojnë komisione për të punuar në çështje të ndryshme të marrëveshjes. Një folës ka thënë se ata duhet ndërmarrë disa iniciativa të përbashkëta, pasi që “në kohëra të vështira është më lehtë të zgjidhen problemet së bashku”. Një tjetër folës ka thënë se parlamentet duhet të krijojnë një mekanizëm për mbikqyrjen e dialogut në Bruksel. Edhe pse një folës ka përkrahur idenë e një mekanizmi të përbashkët monitorues mes dy parlamenteve, shumica kanë menduar se një gjë e tillë është e pamundur të bëhet në këtë fazë. Megjithatë, takimet si ky, të organizuara nga CIG, duhet të vazhdojnë dhe të ofrojnë mundësi për shkëmbimin e informatave.

Dialogu i Brukselit, nën mbikqyrjen e BE-së do të vazhdojë, por pjesëmarrësit kanë qenë skeptik se zyrtarët e Bashkimit Evropian nuk do të jenë po aq të angazhuar sa deri më tash, duke pasur parasysh konfliktet e reja në Evropë e më tej. Në këtë kontekst, ata kanë thënë se bashkëpunimi bilateral është thelbësor në “lëvizjen më të shpejtë të gjërave”.

Disa nga fushat në të cilat parlamentet do të mund të promovonin bashkëpunimin janë arsimi, shëndetësia, personat e zhdukur, ambienti, mediat, kultura, siguria, lufta kundër krimit të organizuar, papunësia, integrimi evropian dhe zhvillimi ekonomik. Bashkëpunimi në këto çështje do të ishte në të mirë të të dyja shoqërive.

Normalizimi pa njohje

Në prill të vitit 2015, CIG ka organizuar në Beograd tryezën e dytë të rrumbullakët për anëtarët e parlamenteve të Serbisë dhe Kosovës. Nënkryetarja e Parlamentit të Zvicrës ka marrë pjesë në diskutim poashtu. Për shumicën e deputetëve nga Prishtina, kjo ka qenë vizita e tyre e parë në Beograd.

Mosmarrëveshja rreth statusit mbetet pengesa kryesore në normalizimin thelbësor të marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës. Kjo është reflektuar edhe gjatë diskutimeve. Pothuasje të gjithë pjesëmarrësit nga Kosova kanë thënë se normalizimi i marrëdhënieve do të jetë i vështirë për aq kohë sa Beogradi të mos e pranojë pavarësinë e Kosovës. “Nuk mund të ndërtoni marrëdhënie normale me një fqinj i cili pretendon ta marrë shtëpinë tënde. Së pari, fqinji duhet ta njohë të drejtën tënde për të pasur shtëpi, e pastaj mund të bëhemi miq”, ka thënë një pjesëmarrës.

Pjesëmarrësit serbë kanë thënë se njohja e Kosovës nga Serbia nuk do të ndodhë, së paku jo në një periudhë të afërt. Duke marrë parasysh këtë dilemë, pjesa më e madhe e folësve kanë favorizuar qasjen ekzistuese të normalizimit, hap pas hapi, duke u marrë së pari me fushat ku marrëveshjet janë të mundshme, e jo duke e ndalur dialogun në tërësi derisa Serbia ta njohë Kosovën. Për ndryshim nga takimet tjera me pjesëmarrësit e rregullt të CIG, parlamentarët kanë insistuar që Kosovës ti referohen si “Republika e Kosovës”, apo në anën tjetër, “Kosova e Metohija”.

Deputetët duhet të luajnë një rol thelbësor sidomos në promovimin e pajtimit dhe tolerancës mes dy shoqërive. Shumë folës kanë theksuar se marrëdhëniet mes shoqërive të tyre ndikohen nga e kaluara e vështirë dhe nga paragjykimet dhe opinionet negative për tjetrin. Edhe gjenerata e lindur pas luftës ka opinion negativ ndaj kosovarëve apo serbëve. Ky opinion nuk bazohet në përvojë vetanake, por në narativa të ndryshme. Kjo duhet të adresohet dhe parlamentarët, duke pasë parasysh lidhjet e tyre të afërta me popullin, do të mund të kontribuonin në këtë drejtim,

duke inicuar ndryshime në sistemin e arsimit, posaçërisht në lidhje me tekstet shkollore të historisë, në organizimin e shkëmbimeve kulturore mes studentëve dhe promovimin e një fushate të përgjithshme të tolerancës. Të dyja shoqëritë duhet ta njohin atë që ka ndodhë, ta marrin pjesën e tyre të përgjegjësisë dhe të ndërmarrin hapa për t'u dhënë drejtësi viktimave. “Përndryshe, femijët tanë do të dëgjojnë vetëm storie të urrejtjes, storie se si në rajonin tonë krimet nuk ndëshkohen dhe rrjedhimisht do ta urrejnë njëri-tjetrin.”

Edhe pse dialogu i Brukselit ka shërbyer si një instrument i dobishëm në ndërprejren e *status quo*-së, sidomos në veri të Kosovës, implementimi i disa marrëveshjeve jodomsdoshmërisht është përkthyer në normalizim të marrëdhënieve. Disa në Kosovë dhe Serbi i vënë në pikëpyetje rezultatet e dialogut, edhe pse e përkrahin atë si instrument të normalizimit të marrëdhënieve.

“Kalimet e kufirit mes Kosovës dhe Serbisë janë më të këqinjta në Evropë”, ka thënë një pjesëmarrës. “Koha që duhet për tu marrë me dokumentet e udhëtimit, zëvendësimi i targave të Kosovës me targa të përkohshme të Serbisë, si dhe çmimi i lartë i sigurimit të veturës (veturat e Kosovës duhet të paguajnë rreth 135 euro për një muaj, kurse serbët paguajnë rreth 20 euro për dy javë), nuk janë barrë shtesë vetëm për buxhetin personal, por poashtu krijojnë një ndjenjë se jeni duke hyrë në territor armiqësor”. Parlamentarët u kanë bërë thirrje Beogradit dhe Prishtinës ti lehtësojnë procedurat e kalimit të kufirit dhe të eliminojnë “pagesat kriminale të sigurimit”. Disa folës kanë thënë se nga pagesa e sigurimeve përfitojnë vetëm kompanitë e sigurimeve në Serbi dhe në Kosovë, të cilat vazhdojnë “ti vjedhin në mënyrë legale qytetarët e tyre”. Ata poashtu kanë përkrahur idenë e një marrëveshjeje për të hequr pagesat shtesë për telefoni mobile jashtë vendit (roaming), si dhe një marrëveshjeje të përgjithshme rreth telekomunikacionit. Të ballafaquar në mënyrë të drejtpërdrejt me këto pengesa dhe pasi që ishte dashur të prisnin për rreth tri orë në kufi për shkak të keqkuptimeve rreth çështjeve logjistike, deputetët e parlamentit të Kosovës kanë thënë se marrëveshja e Brukselit mbi lëvizjen e lirë nuk është e mjaftueshme dhe duhet të rinegociohet, ose në të kundërtën, Prishtina duhet të aplikojë masa reciproke, kanë thënë disa nga pjesëmarrësit.

Ekzistojnë shumë çështje jopolitike ku Beogradi dhe Prishtina do të mund të shënonin progres thelbësor. Një folës serb ka propozuar që kryetarët e komunave të Kosovës të krijojnë kushte më të mira për kthimin e refugjatëve serbë të Kosovës, Prishtina të respektojë kuotat e punësimit për komunitetet pakicë, dhe ligji mbi gjuhët të implementohet më mirë. Këto çështje nuk lidhen me statusin, por me sundimin e ligjit në Kosovë.

“Pesonat e zhdukur” është një çështje tjetër e cila do të mund të ishte zgjidhur po të kishte më shumë vullnet politik. Një folës nga Kosova ka thënë se vetëm javën e kaluar janë varrosur mbetjet e 28 personave të zhdukur në fshatin e saj, kurse 16 ende mbesin të pagjetur. “Derisa të mos hedhim dritë mbi të kaluarën, ajo do të vazhdojë të na ndjekë pas. Ne nuk mund të kemi marrëdhënie normale kur edhe 15 vite pas luftës ende varrosim njerëz”. Janë ende rreth 1700 persona të pagjetur, prej të cilëve rreth 400 janë serbë.

Edhe narrativi rreth çështjes së personave të zhdukur është i ndarë në vija etnike. Ekzistojnë dy memoriale në nderim të të zhdukurve, një në Prishtinë për shqiptarët, dhe një në Graçanicë për serbët. Në diskursin publik përmenden vetëm personat e zhdukur nga njëri komunitet. Vitin e kaluar parlamenti i Kosovës ka miratuar rezolutën për personat e zhdukur, por siç ka thënë një

folës, Beogradi nuk mund ti gjejë serbët e zhdukur, dhe së këndejmi, një kushtëzim i tillë do të kishte kuptim vetëm nëse Prishtina do ta kishte kryer detyrën e saj në gjetjen e tyre”. Një tjetër folës ka thënë se “është hipokrite se si shqiptarët kërkojnë që Beogradi t’i gjejë të zhdukurit nga komuniteti i tyre, por nuk i bëjnë një kërkesë të tillë qeverisë së tyre për gjetjen e serbëve të zhdukur. Është po aq hipokrite se si serbët kërkojnë nga Prishtina të gjejë serbët e zhdukur, por një kërkesë të tillë nuk ia parashtrojnë qeverisë së tyre për të gjetur shqiptarët e zhdukur”.

Një folës ka thënë se deputetët e Serbisë dhe Kosovë do të duhej të krijonin një grup ndërparlamentar të “Miqve të Normalizimit”. Shumica e pjesëmarrësve kanë përkrahur këtë propozim, por disa kanë thënë se ky grup nuk do të mund të funksionojë për aq kohë sa parlamenti i Serbisë nuk e pranon parlamentin e Kosovës si një institucion i një shteti të pavarrur. “Grupe të tilla mund të ekzistojnë vetëm mes të barabartëve. Nëse deputetët e Serbisë mund të na llogarisin si të barabartë, atëherë do të mund ta formojmë këtë grup”. Edhe pse një njohje e tillë ka pak gjasa të vijë nga deputetët serbë, një folës serb ka thënë se ky grup do të mund të ndihmonte në zbutjen e tensioneve dhe në ndërtimin e një momenti për iniciativë të reja dhe se ky grup do të shërbente për të bërë dialog, e jo negociatë.

Grupi për Bashkëpunim

Në qershor të vitit 2015, CIG ka organizuar në Prishtinë tryezën e tretë të rumbullakët për anëtarët e parlamenteve të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë takim, shumica dërrmuese e pjesëmarrësve janë pajtuar që ky bashkëpunim parlamentar të institucionalizohet përmes një mekanizmi joformal të emëruar “Grupi për Bashkëpunim”. Duke krijuar Grupin për Bashkëpunim, anëtarët e të dyja parlamenteve janë përkushtuar për normalizimin e marrëdhënieve mes dy shoqërive dhe të kontribuojnë në implementimin e marrëveshjes së Brukselit. Siç ka thënë njëri nga pjesëmarrësit, “një normalizim i vonuar, është refuzim i normalizimit”.

Pjesëmarrësit kanë rekomanduar që Grupi për Bashkëpunim të takohet rreth katër herë në vit dhe t’i adresojë çështjet praktike në të cilat kapaciteti i tyre zyrtar u mundëson të kontribuojnë më së shumti. Për më shumë, ata do ta intensifikojnë angazhimin e tyre në normalizimin e marrëdhënieve, posaçërisht në avokimin për marrëveshje të caktuara, në formësimin e debateve publike në shoqëritë e tyre, dhe në përmirësimin e perceptimit që opinioni publik në të dyja vendet e ka për njëri tjetrin.

Folësit kanë raportuar për një përparim të dukshëm në nivelin dhe cilësinë e komunikimit mes anëtarëve të të dy parlamenteve. “Deri shumë vonë, debatet janë fokusuar në simbolizëm, ku kemi humbur orë të tëra duke u grindur se a duhet thënë Republika e Kosovës apo Kosova e Metohija. Tani i kemi tejkaluar këto pengesa dhe jemi duke i adresuar problemet reale”. Përkundër përparimit të dukshëm, shumë folës kanë thënë se komuniteti ndërkombëtar duhet të vazhdojë ta udhëheqë procesin, por kanë shtuar se gatishmëria e Prishtinës dhe Beogradit për të marrë për shumë përgjegjësi në këtë proces është duke u rritur.

Njohja e diplomave universitare

Grupi për Bashkëpunim ka adresuar çështjen e njohjes së diplomave universitare. Në vitin 2011, Prishtina dhe Beogradi kanë arritur një marrëveshje për njohjen e diplomave si pjesë e dialogut të Brukselit. Sipas marrëveshjes, Asociacioni i Universiteteve Evropiane (EUA), një institucion

me seli në Bruksel i cili përfaqëson universitetet në 47 shtete, përmes agjencisë së kontraktuar Spark, do të çertifikonte diplomat e lëshuara nga universitetet në Kosovë dhe Serbi, në mënyrë që ato të pranohen si në Serbi ashtu edhe në Kosovë.

Sipas politikave arsimore në Serbi dhe Kosovë, organi më i lartë kompetent për njohjen e diplomave është universiteti në të cilin aplikon studentit. Secili universitet harton rregullat e tij të cilat rregullojnë procedurat e njohjes. Nuk ekzistojnë kritere të qarta dhe të harmonizuara, dhe procesi është ende është duke u zhvilluar si procedurë e “nostrifikimit”, e jo si procedurë e “njohjes”. Nostrifikimi është procedurë e cila fokusohet më shumë në krahasimin e programit të një institucioni të huaj të shkollimit të lartë, e jo aq në rezultatet e studimeve. Nëse ka dallime thelbësore në lëndët mesimore, aplikuesit mund t’i kërkohet t’i nënshtrohet provimeve shtesë. Pra studentët mund të aplikojnë për njohje në universitet pasi ta kenë pranuar çertifikatën nga EUA, por njohja dhe nostrifikimi i diplomave është vendim i universiteteve.

Edhe pse EUA ka çertifikuar më shumë se 400 diploma nga Kosova dhe Serbia, Beogradi ka njohur vetëm 15 sosh, kurse Prishtina ende nuk e ka njohur asnjë. Një përfaqësues i qeverisë së Kosovës ka thënë se Kosova nuk ka qenë në gjendje ta bëjë një gjë të tillë sepse nuk ekziston një rregullore e cila do ta rregullonte këtë proces. Megjithatë, zyrtarët tjerë të Kosovës kanë pranuar se mosnjohja ka qenë poashtu një reagim ndaj pengesave shtesë të vendosura nga Serbia për aplikuesit e Kosovës, diplomat e të cilëve janë pranuar. Serbia ka vendosur hapa shtesë në procesin e njohjes, hapa këta që nuk janë paraparë në marrëveshje. Për më shumë, në maj të vitit 2015, Gjykata Kushtetuese e Serbisë ka marrë vendim që marrëveshja për njohjen e diplomave të Kosovës është jokushtetuese. Megjithatë, qeveria e Serbisë ka gjetur një rrugë të re përreth kësaj çështje, duke lëshuar një dekret të ri i cili mundëson njohjen.

Procedura e njohjes dhe nostrifikimit është e komplikuar, e gjatë dhe e kushtueshme. Ajo mund të zgjasë deri në dy vite dhe të kushtojë rreth 300 euro, prej të cilave pjesa më e madhe janë shpenzime të përkthimit dhe pagesave administrative të universitetit. Këto procedura të komplikuar në Serbi dhe Kosovë vlejnë për të gjithë studentët me diploma të huaja.

Universiteti i Mitrovicës nuk është përfshirë në marrëveshjen e vitit 2011. Shumica dërrmuese e serbëve të Kosovës marrin diploma nga ai universitet, i cili nuk njihet nga Prishtina. Si pasojë, të diplomuarit e universitetit në Mitrovicë nuk mund të punësohen në institucionet qendrore dhe lokale të Kosovës. Pjesëmarrësit në diskutim kanë thënë se nevojitet një marrëveshje e veçantë për universitetin në Mitrovicë. Qeveria e Kosovës është duke përgatitur një propozim për një zgjidhje të përkohshme, e cila nuk do të përfshinte njohjen e universitetit, por do t’i njihje diplomat e tij duke bërë kështu të mundur që të diplomuarit të punësohen në institucionet publike të Kosovës. Sipas kësaj zgjidhje, një komision do t’u lëshonte çertifikatat e nevojshme të diplomuarve të universitetit në Mitrovicë, të cilët më pas do të mund të punonin në institucionet e Kosovës. Zyrtarët qeveritarë të Kosovës kanë thënë se komisioni do të fillojë punën më së largu deri në muajin nëntor të vitit 2015. Megjithatë, plani duhet të miratohet nga Parlamenti i Kosovës.

Pjesëmarrësit kanë sugjeruar që Bashkimi Evropian, si lehtësues i implementimit, do të duhej të intervenonte për të zhbllokuar procesin. Deputetët kanë thënë se ministritë e arsimit të Kosovës dhe Serbisë duhet të përgatisin raporte rreth njohjes së diplomave tek parlamentet e tyre, duke

shpjeguar se përse është bllokuar procesi. Ministritë e arsimit të Kosovës dhe Serbisë duhet të bashkëpunojnë drejtpërdrejt në eliminimin e pengesave teknike në proces. Ata duhet ta centralizojnë procesin e njohjes së diplomave dhe të zhvillojnë procedura të duhura për rregullimin dhe përsheptimin e procesit. Komisionet parlamentare të Serbisë dhe Kosovës duhet të kërkojnë një raport nga Bashkimi Evropian dhe të pyesin nëse agjencioni i kontraktuar, Spark, do të mund të vazhdojë të ndihmojë në këtë proces, apo nëse duhet kontraktuar një tjetër organizatë për të ndërmjetësuar me EUA-në. Kontrata e Spark-ut me EUA-në ka skaduar. Parlamentarët duhet poashtu t'i shohin mundësinë që vetë ata të hartojnë propozime në mënyrë që procesi të zhblokohet.

Dy anëtarë nga secili parlament janë pajtuar që ta adresojnë këtë temë tek qeveritë dhe parlamentet e tyre, dhe të raportojnë për të gjeturat e tyre në takimin e ardhshëm të Grupit për Bashkëpunim. Gjatë vjeshtës së vitit 2015, me iniciativë të këtyre deputetëve, komisionet e arsimit të të dyja parlamenteve kanë organizuar debate. Pyetjet u janë parashtruar ministrave të arsimit, kurse janë mbajtur konsultime me universitete. Grupi planifikon ta rishikojë këtë çështje në takimin e tij të radhës në fillim të vitit 2016, dhe të lëshojë një deklaratë të përbashkët.

BASHKËPUNIMI NË INTEGRIMET EVROPIANE

Një tjetër fushë e adresuar nga procesi i CIG-EDA në vitet 2014-2015 ka qenë bashkëpunimi mes Serbisë dhe Kosovës në fushën e integrimeve evropiane. Të dyja vendet kanë shënuar progres thelbësor në aspiratat e tyre drejt integrimit në Bashkimin Evropian. Edhe pse në faza të ndryshme në procesin e integrimit, ka shumë fusha në të cilat ato mund të bashkëpunojnë.

Në tetor të vitit 2015, CIG ka organizuar në Lubjanë të Sllovenisë, tryezën e parë të rrumbullakët për stafin e Ministrisë së Integrimeve Evropiane të Kosovës dhe Zyrës Qeveritare për Integritet Evropian të Serbisë. Qëllimi i kësaj tryeze të rrumbullakët ka qenë gjetja e fushave të bashkëpunimit mes dy institucioneve, me qëllim të avancimit të proceseve të integrimeve evropiane. Në vazhdim është një listë e përfundimeve dhe rekomandimeve të paraqitura nga pjesëmarrësit.

- *Bashkëpunimi i drejtpërdrejt është i mundur, por është i ndjeshëm.* Ekzistojnë mundësi për bashkëpunim të drejtpërdrejt mes Beogradit e Prishtinës, por ekzistojnë edhe kuffizime për shkak të çështjeve që lidhen me statusin. Bashkëpunimi ndërkuftar është njëra nga fushat ku do të mund të përfitonin të dyja palët por për të cilën ende nuk është arritur ndonjë zgjidhje. Është propozuar që Komisioni Evropian të hartojë një propozim kompromisi për Beogradin dhe Prishtinën, në mënyrë që të shfrytëzohen fondet për bashkëpunim ndërkuftar. Disa folës kanë propozuar që fondet për bashkëpunim ndërkuftar për Kosovën dhe Serbinë të vendosen tek autoritetet nacionale, por sipas disa individëve të afërt me këto fonde, gjasat që një zhvendosje e tillë të ndodhë janë shumë të vogla.
- *Shkëmbimi i përvojave dhe njohurive.* Pjesëmarrësit janë pajtuar për vendosjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e përvojave dhe njohurive rreth procesit të integrimeve evropiane. Në këtë kontekst, stafi i Ministrisë së Integrimeve Evropiane të Kosovës, përgjegjës për përkthimin e *Acqui*-së së BE-së, së shpejti do ta vizitojë Zyren për Integritet Evropian të Serbisë. Vizita do të pasohet nga një vizitë e ngajshme e stafit të Zyrës për Integritet Evropian të Serbisë në Prishtinë.

- *Shkëmbimi i përkthimeve të Acqui-së.* Është vlerësim i të dyja palëve se Beogradi dhe Prishtina duhet të bashkëpunojnë në përkthimin e *Acqui-së*. Beogradi do të mund t'ia jepte Prishtinës verzionin në gjuhën serbe. Beogradi e ka marrë atë nga Kroacia, edhe pse shumë punë është dashur të bëhet për ta harmonizuar dokumentin me gjuhën serbe. Megjithatë, para se profesionistët e kësaj fushe të mund të vazhdojnë, nevojitet një vendim politik nga nivelet më të larta të qeverive përkatëse. Pjesëmarrësit nga Serbia kanë thënë se përkthimi është më i ndërlikuar se sa që mund të duket. Faza e parë përfshin rishikimin e dokumentit, dhe në rastin e Serbisë, janë më shumë se 2000 faqe të cilat duhet të rishikohen duke u bazuar në legjislacionin e BE-së. Serbia ka punësuar rreth 400 ekspertë për ta bërë rishikimin. Ekspertët janë të specializuar në fushën ligjore dhe gjuhësore, si dhe në fusha të specializuara të bujqësisë, ekonomisë, veterinarisë e fusha tjera. Pjesëmarrësit nga Kosova kanë thënë se janë duke bashkëpunuar me Shqipërinë në përkthimin në gjuhën shqipe, pasi që Shqipëria është duke kaluar nëpër procesin e përkthimit tani.
- *Trajnime mbi procesin e integritit evropian.* Procesi i integritit evropian është proces i gjatë dhe i ndërlikuar, kështu që trajnimet për të punësuarit në këto resorë do të ishin një ndihmesë shumë e madhe. Serbia e ofron një shërbim trajnues në Ministrinë e Administratës Publike dhe Vetëqeverisjes Lokale ku, mes tjerash, shpjegohet *Acqui* dhe ofrohen trajnime për përgatitjen e projekt propozimeve. Trajnime të tilla mund të zgjerohen e të përfshijnë edhe fusha tjera. Poashtu, stafi nga Prishtina dhe ai nga Beogradi do të mund të punonin në përgatitjen e projekteve të përbashkëta dhe në shkëmbimin e ekspertizës dhe njohurive.
- *Shoqëria civile dhe integriti evropian.* Bashkëpunimi me shoqëri civile në të gjithë kapitujt është një ndihmesë e madhe. Qeveria e Serbisë ka krijuar një zyre për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile me qëllim të shkëmbimit të informatave, marrjes së këshillave, adresimit të brengave të publikut, si dhe garantimin e një procesi transparent. Përmes një konvente në OJQ-ve të formuluar rishtas, organizatat e shoqërisë civile në Serbi kanë marrë një rol monitorues, në vend se të jenë pjesëmarrës të drejtpërdrejt në procesin negociator. Prishtina poashtu takohet rregullisht me përfaqësuesit e shoqërisë civile rreth procesit të integritit në BE. Organizatat e shoqërisë civile ofrojnë kontributin e tyre në lidhje me kapitujt, si dhe mbajnë takime të rregullta me zyrtarët qeveritarë. Ata poashtu marrin pjesë në hartimin e planeve të veprimit.

Edhe pse bashkëpunimi mes Beogradit e Prishtinës është ende i limituar, pjesëmarrësit kanë thënë se integriti në BE i bashkon të dyja palët rreth një qëllimi të përbashkët. Ata kanë thënë se zyrtarët e të dyja palëve do të duhej të ishin më inventiv dhe fleksibil në gjetjen e mënyrave për shfrytëzimin e fondeve të ofruara nga BE-ja, siç janë ato për bashkëpunimin ndërkufitar. Palët poashtu mund të bashkëpunojnë në transpozimin më efikas të legjislacionit, në krahasimin e përvojave rreth harmonizimit të legjislacionit, si dhe në procesin e ekzaminimit.

Të dyja institucionet do ta vazhdojnë diskutimin e filluar në Lubjanë në vitin 2015-2016, dhe CIG do ta organizojë takimin e tyre të rradhës në fillim të vitit 2016.

PJESËMARRËSIT*

Dukagjin Abdylj, Kryesues, Departamenti për Çështje Ligjore të BE-së, Ministria e Integritimeve Evropiane e Kosovës

Arnaldo Abruzzini, Sekretar i Përgjithshëm, Eurochambres

Farina Ahäuser, Zyrtare e Deskut Politik, Drejtorati Gjeneral për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim, Komisioni Evropian

Mimoza Ahmetaj, Ambasadore e Kosovës në Belgjikë

Katharina Ahrendts, Zëvendëskryesuese e Departamentit për Ballkanin Perëndimor, Zyra e Jashtme Federale e Gjermanisë

Ardian Arifaj, Këshilltar i Ministrit të Punëve të Jashtme

Roberto Balzaretto, Ambasador i Zvicrës në Bashkimin Evropian

Besim Beqaj, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës

Vjosa Beqaj, Drejtoreshë, Departamenti i Politikave Sektoriale, Ministria e Integritimeve Evropiane e Kosovës

Ksenija Božović, Kryetare, Asambleja Komunale Mitrovicë Veri

Bekim Çollaku, Ministër i Integritimeve Evropiane të Kosovës

Gordana Čomić, Nënkryetare, Parlamenti i Serbisë, Partia Demokratike

Aida Ćorović, Anëtare e Parlamentit të Serbisë, Partia Demokratike

David Cullen, Kryesues, Njësiti për Kosovë, Drejtorati Gjeneral për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim, Komisioni Evropian

Ilir Deda, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje

Gordana Delić, Drejtoreshë Ekzekutive, Trusti i Ballkanit për Demokraci

Jelena Đokić, Këshilltare e Kryetarit të Komunës së Zveqanit

Jelena Đorić, Këshilltare e pavarur, Komisioni për Kosovë dhe Metohi, Parlamenti i Serbisë

Milovan Drecun, Kryesues, Komisioni për Kosovë dhe Metohi, Parlamenti i Serbisë

Ivana Đurić, Ndhmës Drejtoreshë, Zyra për Integritime Evropiane e Serbisë

Marko Đurić, Drejtor, Zyra për Kosove dhe Metohi, Qeveria e Serbisë

Nenad Đurić, Komandant Rajonal i Policisë, Policia e Kosovës

Natasa Elezović, Këshilltare e Kryetarit të Komunës Mitrovicë Veri

Zdravka Erak, Këshilltare e lartë, Komisioni për Kosovë dhe Metohi, Parlamenti i Serbisë

Sadri Ferati, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës

Bujar Gallopeni, Koordinator për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës

Shpetim Gashi, Zëvendëspresident, Këshilli për Qeverisje Inkluzive

Bajram Gecaj, Zëvendësminister i Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës

Ardian Gjini, Zëvendëskryesues, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

Dukagjin Gorani, Kryesues, Forumi Zëri i Përbashkët (*Common Voice*)

Blerim Grainca, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës

Alex Roinishvili Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Inkluzive

Riza Halimi, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia për Veprim Demokratik

Teuta Haxhiu, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

* Shumë prej pjesëmarrësve i kanë ndërruar titujt/pozitat e tyre gjatë kohezgjatjes së programit të CIG-FDFA. Në këtë liste janë shënuar vetëm titujt/pozitat të cilat kanë qenë valide në takimin e fundit në të cilin kanë marrë pjesë secili prej tyre.

Adrijana Hodžić, Zyrtare Ekzekutive , Zyra Administrative Mitrovicë Veri
Valerie Hopkins, Gazetare, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese
Labinot Hoxha, Sekretari i Parë, Ambasada e Kosovës në Belgjikë
Ramadan Ilazi, Zëvendësministër i Integritimeve Evropiane të Kosovës
Marko Jakšić, Avokat, Mitrovicë
Dušan Janjić, President, Serbia Aktive
Dalibor Jevtić, Ministër për Kthim dhe Komunitete të Kosovës
Jadranka Joksimović, Ministre pa portofol përgjegjëse për Integritet Evropiane, Qeveria e Serbisë
Vesna Jovanović, Drejtoreshë për Arsim, Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Rini dhe Sport, Komuna e Parteshit
Barbara Jesus-Gimeno, Zyrtare e Deskut Politik, Njësi për Serbi, Drejtorati Gjeneral për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim, Komisioni Evropian
Lirije Kajtazi, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Adriatik Kelmendi, Kryeredaktor, Kohavision
Selatin Kllokoti, Zyrtar i Programit, Instituti Demokraci për Zhvillim
Blerta Deliu Kodra, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës
Glauk Konjufca, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Biljana Hasanovic Korać, Anëtare e Parlamentit të Serbisë, Partia Social-Demokrate
Mirjana Kosić, Drejtoreshë Ekzekutive, TransConflict
Vladeta Kostić, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe
Dusan Kozarev, Zëvendës Drejtor, Zyra për Kosovë dhe Metohi, Qeveria e Serbisë
Dragiša Krstović, Këshilltar Politik, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Arbër Kuçi, Bashkëpunëtor, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Nada Lazić, Anëtare e Parlamentit të Serbisë, Lidhja e Social-demokratëve të Vojvodinës
Sonja Licht, Presidente, Fondi i Beogradit për Shkëlqesi Politike
Ulrike Lunacek, Zëvendëspresidente, Parlamenti Evropian
Leon Malazogu, Drejtor Ekzekutiv, Instituti Demokraci për Zhvillim
Ljubomir Marić, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës
Christa Markwalder, Nënkryetare, Parlamenti i Zvicrës
Qemajl Marmullakaj, Drejtor, Zyra për Planifikim Strategjik, Qeveria e Kosovës
Krystyna Marty Lang, Ambasadore e Zvicrës në Kosovë
David McAllister, Anëtar, Parlamenti Evropian
Boyd McKechnie, Këshilltar Politik i Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë
Bardhyl Metaj, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Pauline Menthonnex Gacafferri, Zëvendës shefe e Misionit, Ambasada e Zvicrës në Serbi
Milivoje Mihajlović, Drejtor, Radio Beogradi
Jugoslav Milačić, Këshilltar i ministrit pa portofol në Qeverinë e Serbisë, përgjegjës për Integritet Evropiane
Ksenija Milenković, Drejtoreshë, Zyra për Integritet Evropiane, Qeveria e Serbisë
Petar Miletić, Ish-nënkryetar, Parlamenti i Kosovës
Smiljka Milisavljević, Profesor, Universiteti në Mitrovicë
Pierre Mirel, Drejtor i Përgjithshëm Nderi, Komisioni Evropian
Tanja Mišević, Kryesuese, Ekipi Negociator për Anëtarësim të Republikës së Serbisë në Bashkimin Evropian, Qeveria e Serbisë
Dardan Molliqaj, Sekretar, Lëvizja Vetëvendosje

Mary Teresa Moran, Zëvendëskryesuese, Njësi për Kosovë, Drejtorati Gjeneral për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim, Komisioni Evropian

Engjellushe Morina, Kryesuese, Këshilli i Prishtinës për Marrëdhënie me Jashtë

Valon Murtezaj, Këshilltar Politik i Kryeministrit të Kosovës

Ganimete Musliu, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës

Branislav Nešović, Drejtor i Programit, Aktiv

Dragan Nikolić, Kryetar i Komunës së Parteshit

Predrag Nikolić, Zëvendës zyrtar ndërlidhës në Misionin e BE-së në Prishtinë

Randel Nojkić, Ish-anëtar i Parlamentit të Kosovës

Igor Novaković, Bashkëpunëtor, Këshilli për Qeverisje Inkluzive

Jean-Luc Oesch, Zëvendës Shef i Misionit, Ambasada e Zvicrës në Serbi

Vladimir Orlić, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe

Rascha Osman, Sekretari i Parë, Misioni i Zvicrës në Bashkimin Evropian

Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës

Zoran Ostojić, Ish-anëtar i Parlamentit të Serbisë

Pablo Padrutt, Atashe, Ambasada e Zvicrës në Kosovë

Zenun Pajaziti, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës

Krstimir Pantić, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe

Jean-Eric Paquet, Drejtor për Ballkanin Perëndimor, Drejtorari Gjeneral për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim, Komisioni Evropian

Dejan Pavičević, Zyrtar ndërlidhës në Misionin e BE-së në Prishtinë

Lulzim Peci, Drejtor Ekzekutiv, Instituti Kosovar për Hulumtim të Politikave dhe Zhvillim

Slobodan Petrović, Nënkryetar, Parlamenti i Kosovës, Lista Serbe

Milena Popović, Këshilltare e Drejtorit të Zyrës për Integritet Evropian të Serbisë

Srdan Popović, Drejtor, Zyra për Komunitete e Kryeministrit të Kosovës

Gazmir Raci, Këshilltar i ministres pa portofol, përgjegjëse për dialogun me Serbinë në Qeverinë e Kosovës

Dragana Radojičić, Ndhmës Drejtoreshë, Zyra për Integritet Evropian të Serbisë

Nenad Radosavljević, Drejtor i Bordit, Rrjeti i TV stacioneve serbe në Kosovë

Darko Radovanović, Kryetar, Asambleja Komunale e Zveqanit

Goran Rakić, Kryetar i Mitrovicës Veri

Katarina Rakić, Anëtare e Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe

Živojin Rakočević, Drejtor, Qendra Kulturore, Graçanicë

Naim Rashiti, Analist i lartë, Grupi i Ballkanit për Hulumtim të Politikave

Ernst Reichel, I dërguari Special për Evropë Juglindore, Zyra e Jashtme Federale e Gjermanisë

Fisnik Rexhepi, Këshilltar i lartë Politik i Ministrit të Integritet Evropian të Kosovës

Alessandro Rotta, Këshilltar Politik i Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë

Jean-Daniel Ruch, Ambasador i Zvicrës në Serbi

Norbert Rüttsche, Sekretar i Parë-Këshilltar i Sigurisë Njerëzore, Ambasada e Zvicrës në Kosovë

Branko Ružić, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë

Teuta Sahatqija, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Lidhaje Demokratike e Kosovës

Roland Salvisberg, Kryesues, Politika e Paqes e Departamentit të Sigurisë Njerëzore, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës

Saskia Salzmann, Sekretare e Parë-Këshilltare e Sigurisë Njerëzore, Ambasada e Zvicrës në Kosovë

Aleksandra Šanjević, Koordinatore e Programit, Fondacioni për Shoqëri të Hapur

Petrit Selimi, Zëvendësministër i Punëve të Jashtme

Besa Shahini, Analiste e lartë, Iniciativa Evropiane për Stabilitet

Blerim Shala, Koordinator për Dialogun me Serbinë dhe anëtar i Parlamentit të Kosovës

Demush Shasha, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Integritimit Evropian të Kosovës

Predrag Simić, Profesor, Universiteti i Beogradit

Sanja Sovrlić, Gazetare, Radio TV Mir

Julien Stauffer, Atashe, Ambasada e Zvicrës në Kosovë

Branimir Stojanović, Kryetar i Graçanicës

Christof Stock, Shef i Operacioneve, Zyra e BE-së në Kosovë

Milos Subotić, Koordinator i Projektit, Universiteti në Mitrovicë

Edita Tahiri, Ministre pa portofol në Qeverinë e Kosovës, përgjegjëse për dialogun me Serbinë

Jovan Teokarević, Profesor, Universiteti i Beogradit

Evin Thana, Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ligjor, Ministria e Integritimit Evropian të Kosovës

Bojana Todorović, Këshilltare, Komisioni për Kosovë dhe Metohi, Parlamenti i Serbisë

Rada Trajković, Ish-anëtare e Parlamentit të Kosovës, Lista e Bashkuar Serbe

Laura Trimajova, Ndhimëse parlamentare e një anëtari të Parlamentit Evropian

Jelena Trivan, Drejtoreshë, Qendra për Politika dhe Vlera Evropiane

Janko Veselinović, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Lëvizja *Preokret*

Dragan Vladislavljević, Drejtor, Zyra për Koordinimin e Aktiviteteve në Procesin Negociator me Prishtinën, Qeveria e Serbisë

Arbër Vllahu, Shef i Stafit të Presidentes së Kosovës

Nataša Vučković, Anëtare e Parlamentit të Serbisë, Partia Demokratike

Vanja Vukić, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë

Stevan Vulović, Kryetar i Zubin Potokut

Catherine Wendt, Kryesuese, Njësi për Serbinë, Drejtorati Gjeneral për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim, Komisioni Evropian

Talia Wohl, Zyrtare e Programit, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës

Samuel Žbogar, Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë dhe Shef i Zyrës së BE-së në Kosovë

Armend Zemaj, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës

Këshilli për Qeverisje Inkluzive

BORDI

Steven L. Burg (Chairman)

Universiteti Brandeis

Gordon N. Bardos

SEERECON

Michael W. Elf

Springer Nature

Alex Roinishvili Grigorev

Këshilli për Qeverisje Inkluzive, Universiteti Arcadia

STAFF

Alex Roinishvili Grigorev, President

Shpetim Gashi, Zëvendëspresident

Robert K. Aitkens, Kontabilist

Arbër Kuçi, Bashkëpunëtor

Igor Novaković, Bashkëpunëtor